



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.626Akti

Nr.754 Vendimi
Tiranë, më 05.04.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko Kryesuese
Alma Faskaj Relatore
Xhensila Pine Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 3.4.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Mirela Mishgjoni**, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

Pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni, aktualisht me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është subjekt rivlerësimi, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.12.2020 zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykuese, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Xhensila Pine dhe Pamela Qirko. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Alma Faskaj.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Xhensila Pine, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Mirela Mishgjoni nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive;*
- *ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka dërguar raportin² e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016 ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 13.3.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit në datën 13.3.2024 u njoftua mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.3.2021.

² Raport nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin të KDZH nr. ***, datë 22.9.2023.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.11.2019.

rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 21.3.2024, ndërsa në datën 27.3.2024 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 28.3.2024.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 3.4.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.

19. Subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Mirela Mishgjoni ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Referuar vendimit nr. 2/2017⁴ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

⁴ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21.2 Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuara pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

23. Subjekti ka filluar detyrën në shtator të vitit 1995, fillimisht duke ushtruar funksionin si ndihmës gjyqtare deri në datën 8.2.1996, datë në të cilën është emëruar në detyrën e gjyqtares. Në datën 15.7.2002, me vendimin nr. *** të Këshillit të Lartë të Drejtësisë⁵, ndaj subjektit të rivlerësimit është marrë masa e shkarkimit nga detyra.

24. Ky vendim i KLD-së është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. ***, datë 18.11.2002, kanë vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit për anulimin e vendimit nr. *** të KLD-së.

25. Në vijim të ndjekjes së rrugës së ankimit, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. ***, datë 12.11.2004, ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. *** të KLD-së dhe vendimit nr. *** të Gjykatës së Lartë, si dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në KLD.

26. KLD-ja me vendimin nr. ***, datë 24.10.2008, ka vendosur sërish shkarkimin e subjektit.

27. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. ***, datë 6.2.2009, kanë vendosur shfuqizimin e vendimit nr. *** të KLD-së.

28. Në datën 28.2.2009, subjekti i është rikthyer ushtrimit të funksionit si gjyqtare. Në mungesë të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë për rikthimin në detyrë të subjektit, kjo e fundit i është drejtuar Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg. Në datën 7.12.2010,

organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse".

⁵ Në vijim KLD.

kjo Gjykatë ka konstatuar shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me mjetet efektive që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e proceseve të heqjes nga puna nga organet kompetente.

Në deklaratën *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

29. Apartament banimi⁶ me sip. 111.6 m² (sip. bruto 120.7 m²), ndodhur në lagjen “****”, Vlorë, blerë në datën 3.5.2006. Vlera: 60,000 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti si shef kuzhine i bashkëshortit dhe aktiviteti si avokate i deklarueses⁷.

Hetimi⁸/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

29.1 Nga hetimi rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratë kapari nr. ***, datë 3.5.2006, me objekt blerjen e ardhshme të pasurisë apartament i tipit 1, me sip. 120.7 m², i ndodhur në lagjen “****”, Vlorë, në shumën 60,000 euro. Në nenin C.2 të kontratës, ndër të tjera, parashikohet se: “...në datën e sotme pala blerëse e ardhshme ka paguar shumën 35,000 euro, brenda datës 31.8.2006 do të likuidohet shuma 19,000 euro, si dhe brenda datës 31.12.2006 do të likuidohet shuma 6,000 euro...”. Në datën 8.10.2013, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë lidhur kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.10.2013, me objekt shitjen e pasurisë apartament nr. ***, me sip. 111.6 m², i ndodhur në z. k. ***, Vlorë.

29.2 Në nenin e kontratës me emërtimin “Çmimi dhe mënyra e pagesës” parashikohet se në marrëveshje të përbashkët sipas kontratës së kaparit nr. ***, datë 3.5.2006, palët kanë rënë dakord që apartamenti të blihet për shumën 60,000 euro. Vlera e mësipërme është likuiduar me këste si vijon: kësti i parë në shumën 25,000 euro është likuiduar nëpërmjet Bankës Popullore, në datën 22.12.2005; kësti i dytë në shumën 10,000 euro është likuiduar nëpërmjet Bankës Popullore, në datën 3.5.2006; kësti i tretë në shumën 19,000 euro është likuiduar nëpërmjet Bankës Popullore, në datën 23.8.2006; kësti i katërt në shumën 4,864 euro është likuiduar tek shoqëria “*****” sh.p.k. me mandatin nr. ***, në datën 5.6.2007. Diferenca e mbetur në shumën 1,136 euro është likuiduar me këste të vogla për kryerje punimesh.

29.3 Nga hetimi rezultoi e provuar se pagesat për blerjen e kësaj pasurie janë dokumentuar përkatësisht me: mandatderdhjen *cash* për të tretë, Banka Popullore, datë 22.12.2005, paguar shuma 25,000 euro nga subjekti i rivlerësimit për llogari të shoqërisë “*****” sh.p.k.; mandatderdhjen *cash* për të tretë, Banka Popullore, datë 3.5.2006, paguar shuma 10,000 euro nga subjekti i rivlerësimit për llogari të shoqërisë “*****” sh.p.k.; mandatderdhjen *cash* për të tretë, Banka Popullore, datë 24.8.2006, paguar shuma 19,000 euro nga subjekti i rivlerësimit për llogari të shoqërisë “*****” sh.p.k.; mandatarëtimin nr. ***, datë 5.6.2007, paguar shuma 4,864 euro nga subjekti i rivlerësimit në arkën e shoqërisë “*****” sh.p.k. Në këtë mandat specifikohet se kjo pagesë përbën këstin e fundit.

29.4 Sa më sipër, nga hetimi i Komisionit nuk rezultuan problematika për sa i përket deklarimeve të bëra nga subjekti për vlerën e kësaj pasurie, çmimin e paguar dhe kohën e pagesës së saj. Transaksionet bankare krijojnë një panoramë të saktë dhe të plotë, pa ngritur dyshime lidhur me çmimin dhe mënyrën e pagesës së saj.

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: certifikatë dhe kartelë pronësie datë 6.11.2013; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2013; kontratë kapari nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.5.2006.

⁷ I njëjti deklaram është bërë edhe në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës.

⁸ Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.3.2021, e FSHU-së; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.3.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.3.2021, e QKB-së; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.8.2023, e UKV-së.

Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë

Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim të pasurisë: “Të ardhura nga aktiviteti si shef kuzhine i bashkëshortit dhe aktiviteti si avokate i deklarueses”.

29.5 Të ardhurat nga avokatia të subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni, për periudhën 2004 – 2007

29.5.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se në periudhën janar 2004 – janar 2009 ka ushtruar profesionin e lirë të avokatit. Me qëllim hetimin lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer si burim për këtë pasuri, janë të ardhurat nga viti 2004 deri në vitin 2007. Të ardhurat e krijuara për periudhën 2008 – 2009 janë objekt i analizës për burimin e krijimit të likuiditetit *cash*, të deklaruar dhe të analizuar në pikën 38.4 të këtij vendimi.

29.5.2 Nga hetimi ka rezultuar se në periudhën 2004 – janar 2006 subjekti i rivlerësimit ka ushtruar profesionin e avokatit, fakt ky që provohet me vendimet gjyqësore të depozituara prej saj⁹, por gjatë kësaj periudhe subjekti nuk rezultoi i regjistruar në organet tatimore¹⁰. Në analizë të burimit të ligjshëm konform nenit D, pika 3 e Kushtetutës, Komisioni çmon se të ardhurat e subjektit të deklaruar nga avokatia për periudhën 2004 – 2006 nuk mund të konsiderohen si burim i ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie.

29.5.3 Nga hetimi rezultoi se sipas informacionit të ardhur nga Bashkia Vlorë¹¹ për të ardhurat e subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të aktivitetit si avokate, rezultoi një qarkullim i deklaruar në vlerën 3,000,000 lekë, ku taksa vendore dhe tatimi i biznesit të vogël është në vlerën 14,800 lekë. Për pasojë, për vitin 2007 është përfshirë në analizën e Komisionit vlera 2,388,160 lekë, e cila është llogaritja me 80% e marzhit të fitimit të vlerës së deklaruar nga subjekti dhe për të cilin janë shlyer detyrimet tatimore sipas legjislacionit të kohës (ligji nr. 9632, datë 30.10.2006¹² “Për sistemin e taksave vendore”, personat fizikë jo subjekt TVSH paguajnë taksën e biznesit të vogël dhe taksën vendore në zyrën e Tatim-Taksave pranë bashkive), e pasqyruar kjo vlerë në tabelën si më poshtë.

Tabela nr. 1

Viti	Qarkullimi i deklaruar	Fitimi pas taksave	Të ardhurat e llogaritura me marzhin 80%	Të ardhurat e deklaruar nga subjekti në deklarata	Të ardhurat e përfshira në analizë
2007	3,000,000 lekë	2,985,200 lekë	2,388,160 lekë	n/a	2,388,160 lekë

29.5.4 Subjektit i kaloi barra e provës lidhur me konstatimin e vlerave të ndryshme të të ardhurave reale nga ato të deklaruar.

⁹ Pyetësorët nr. 2 dhe 5.

¹⁰ QKB-ja informon se subjekti është regjistruar si person fizik me NIPT ***, në datën 9.5.2007.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 21.8.2023, e Bashkisë Vlorë.

¹² Neni 10 parashikon: “Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8,000,000 lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël”. Ndërsa neni 11, pika 4 parashikon: “Për bizneset me qarkullim më të madh se 2 milionë lekë deri në 8 milionë lekë në vit, detyrimi fiskal tregues është i barabartë me shumën e detyrimit për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, shtuar me vlerën që del nga shumëzimi i madhësisë prej 1,5 % me vlerën në lekë të mesit të çdo intervali prej 1 milion lekësh, sipas të cilit ndahet intervali i qarkullimit 2-8 milionë lekë”, përjashtuar rastet e ambulanteve dhe të transportit, të cilat kanë një mënyrë tjetër taksimi, që tregohet në të njëjtin aneks.

29.5.5 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës në lidhje me të ardhurat nga avokatia¹³, parashtrroi: “...konstatohet se nga ana Komisionit nuk është analizuar, si dhe nuk janë evidentuar të ardhurat e deklaruara nga ana ime nga avokatia për vitet 2004 – 2006. Në lidhje me këto të ardhura, gjatë hetimit administrativ Komisioni më ka kërkuar të depozitoj vendime gjyqësore, të cilat i kam vënë në dispozicion. Në lidhje me këto vendime konstatohet lehtësisht se nga ana ime gjatë viteve 2004 – 2006 është ushtruar profesioni i avokatit. Është e vërtetë që unë nuk kam qenë e regjistruar në organet tatimore, por ndërkohë unë e kam ushtruar këtë profesion e pajisur me licencën e avokatisë të rinovuar për çdo vit, të cilat ia kam vënë në dispozicion Komisionit...”.

29.5.6 Bashkëlidhur pyetësorit nr. 3 subjekti, për vitin 2004, ka vënë në dispozicion të Komisionit 51 vendime, nga të cilat 34 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe 17 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Subjekti shpjegon se: “...po të llogarisim minimalisht secilën çështje të trajtuar në këto vendime, nga të dhënat e administruara rezulton se unë kam krijuar në total për këto vite të ardhura në shumën 5,010,000 lekë, të cilat nuk i gjej të pasqyruara në analizën financiare të Komisionit, duke u deklaruar vetëm fakti se unë nuk kam qenë e regjistruar në organet tatimore. Gjithashtu, unë këto të ardhura i kam deklaruar edhe në DPV/2004 në vlerën 1,000,000 lekë për vitin 2004, ndërsa në vitet e tjera nuk kam pasur detyrim për të deklaruar...”.

Vlerësimi i Komisionit

29.5.7 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se rezulton e provuar se subjekti ka ushtruar profesionin e avokatit për periudhën 2004 – 2006, duke përfutur edhe të ardhura, të cilat i ka deklaruar gjithashtu në DIPP/2004 të ardhura nga avokatia në vlerën 1,000,000 lekë. Por, duke qenë se subjekti e ka ushtruar profesionin e avokatit i paregjistruar në organet tatimore, por vetëm duke pasur një licencë për ushtrimin e profesionit të avokatit, këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën financiare. Lidhur me të ardhurat për periudhën 2007 – 2009, Komisioni vlerësoi të përfshijë të ardhurat neto të llogaritura me marzhin e fitimit 90%, duke u mbështetur në praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit¹⁴ mbi të ardhurat nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë. Komisioni çmon se e ardhura totale që duhet të përfshihet në analizën financiare nga ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë prej subjektit është vlera 4,876,680 lekë.

29.6 Të ardhurat e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit, z. B.V, nga shitja e shoqërisë “**” S.N.C. dhe emigracioni**

29.6.1 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi në deklaratën Vetting: “Të ardhura nga emigracioni në Itali 1992 – 2005, të ardhura të siguruara nga punësimi në mënyrë të ligjshme; punësimi si punonjës i pasiguruar, si dhe nga shitja e një restoranti në Itali në vitin 2004, në shumën rreth 123,000 euro”.

29.6.2 Subjekti me deklaratën Vetting¹⁵ përcjell deklaratën e hartuar në gjuhën italiane, datë 15.7.2004, para noterit L.Z, i regjistruar në qytetin e Firences, Itali, në të cilën përshkruan historikun e veprimeve juridike dhe financiare të kryera midis shtetasve V.B, B.V dhe shoqërisë së tyre “****” S.N.C., me shtetas të huaj, me objekt “Shitblerjen e aktivitetit “****”, restorant”, me adresë Pratto, ***. Noteri deklaroi se shtetasit V.B dhe B.V kanë likuiduar deri në datën

¹³ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

¹⁴ Vendimi nr.6/2022, (JR), datë 12.03.2022, Vendimi nr.20/2023 (JR), datë 03.05.2023

¹⁵ Dosja ILDKPKI, aneks nr. 4/16.

5.4.2004 shumë 87,798 euro për blerjen e këtij aktiviteti nga shtetasit e huaj, përfaqësuesit e shoqërisë “****” S.A.S. Ndërsa deklarohet se më pas ky aktivitet i është shitur shoqërisë “****”, në vlerën totale 135,000 euro, në datën 15.7.2004, nga përfaqësuesit e shoqërisë “****” S.N.C., shtetasit V.B dhe B.V. Në vlerën e shitjes përcaktohet se çmimi total do të përfshijë shumë 41,573 euro për emrin e mirë dhe shumë 93,427 euro për pajisjet.

29.6.3 Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit një fletë garancie me nr. ***, datë 14.7.2004, lëshuar nga “****” S.P.A., shoqëri ndërmjetësimi financiar, ku shoqëria “****” garanton nëpërmjet saj pagesën e vlerës 41,573 euro përgjatë periudhës 14.7.2004 – 30.9.2009, e cila përbënte pagesën e emrit të mirë të restorantit. Bashkëlidhur fletës së garancisë përcillen kopje të 8 kambialeve të lëshuara në datën 15.7.2004, secila prej tyre në shumë 1,385.76 euro¹⁶, të cilat bëhen të vlefshme për tërheqje pranë Uni Credit Bank, duke filluar nga data 15.6.2008 deri më 15.8.2009.

29.6.4 Gjatë hetimit, me pyetësin nr. 2¹⁷, subjekti deklaron: *“Bashkëshorti B.V ka jetuar në Itali gjatë periudhës 1992 – 2005. Ai ka qenë dhe vazhdon të jetë me profesion shef kuzhine dhe në vitin 2002 së bashku me shtetasin V.B ka krijuar shoqërinë “****” S.N.C., me objekt të ushtrimit të aktivitetit “Restorant”, me vendndodhje në P., Itali. Sipas dokumentacionit dhe marrëveshjes midis tyre, shoqëria ka pasur kapital në vlerën 2,000 euro. Pjesa takuese e secilit prej ortakëve ka qenë 50% secili...”. Subjekti sqaron se: “Në vitin 2004, bashkëshorti kishte vendosur të kthehej në Shqipëri dhe, si rrjedhojë, ka vendosur të shiste aktivitetin. Në datën 6.2.2004 është lidhur kontrata paraprake e shitblerjes me shtetasin G.R, në cilësinë e blerësit të ardhshëm për llogari të të tretëve... Rezulton se në datën 15.7.2004 është realizuar kontrata përfundimtare e shitjes ...vlera përfundimtare e shitjes së aktivitetit, licencave përkatëse dhe pajisjeve është përcaktuar 135,000 euro, nga të cilat 41,573 euro do të paguheshin gjatë periudhës 14.7.2004 – 30.9.2009 nëpërmjet urdhërhirimeve, në vlerën 1,385.76 euro secili urdhërhirim, ndërsa pjesa tjetër u është dorëzuar shitësve. Pavarësisht se shoqëria është themeluar me kontribut të barabartë prej 1,000 euro secili, gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit bashkëshorti veprroi edhe në cilësinë e shefit të kuzhinës. Impenjimi i bashkëshortit si shef kuzhine ishte edhe faktori i rritjes së vlerës së këtij biznesi, ku nga një restorant kinez u kthye në një restorant prestigjioz, me një klientelë fikse. Për më tepër, bashkëshorti nuk është paguar me pagë mujore si shef kuzhine gjatë gjithë periudhës që ka ushtruar këtë aktivitet. Si rrjedhojë, ndarja e të ardhurave të realizuara nga shitja u ra dakord me ortakun tjetër që 80% t’i shkonte bashkëshortit dhe 20% ortakut tjetër”.*

29.6.5 Bashkëlidhur përcjell deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.3.2023, të shtetasit V.B, i cili deklaron se: *“Shuma e shitjes si më sipër përshkruar në dakordësinë tonë është ndarë, B.V në masën 80% dhe unë V.B në masën 20%, pasi kontributi i B.V si shef kuzhine ishte dominant dhe vendosëm ndarjen si më sipër... Unë deklaroj se me marrjen e shumës 27,000 euro, që përbën pjesën time takuese... e pas likuidimit të shumës 108,000 euro nga z. B.V ne i dhamë fund ortakërisë tonë dhe nuk kemi pasur asnjë pretendim ndaj njëri-tjetrit për sa i përket përfitimeve nga kjo shoqëri”.*

29.6.6 Sipas aktit paraprak të blerjes së aktivitetit datë 6.2.2004, me palë shitëse V.B dhe B.V, si aksionarë të shoqërisë “****” S.N.C. dhe palë blerëse R.G, përcaktohet se çmimi i shitjes

¹⁶ Vlera totale 11,086 euro.

¹⁷ Përgjigjja nr. 9, shkronjat “a” dhe “d”, pyetësi nr. 2.

është 200,000 euro, i cili parashikohej se do të shlyhej sipas përcaktimeve të dhëna në tabelën nr. 2.

Tabela nr. 2

Pagesa <i>cash</i> në çastin e nënshkrimit të kontratës paraprake të shitjes, datë 6.2.2004	5,000 euro
Do të paguhet <i>cash</i> deri në datën 15.4.2004	20,000 euro
Do të paguhet në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes, pasi shoqëria të jetë çregjistruar me kambiale	25,000 euro
Është shuma e paguar me anë të një kambiali për shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë “***”, me afat 50 ditë nga nënshkrimi i kontratës së shitjes dhe transferimin e shoqërisë brenda datës 31.5.2004	68,427 euro
Do të paguhet në 60 këste me kambiale mujore, në shumën 1,359.55 euro, pas 60 ditësh nga marrja në posedim (datë 31.5.2004)	81,573 euro
Totali	200,000 euro

29.6.7 Vlera e kambialeve të përcjella¹⁸ nga subjekti dhe të transferuara në llogarinë e tij pranë bankës Monte dei Paschi di Siena është pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 3

Viti	2006	2007	2008	2009	Totali
Shuma e kambialeve e transferuar në bankë	8,102 euro	8,315 euro	5,543 euro		21,959 euro
Kopje të kambialeve			5,543 euro	5,543 euro	11,086 euro
Totali i kambialeve					33,045 euro

29.6.8 Sipas pikës 4 të aktit paraprak të shitjes së shoqërisë¹⁹ parashikohet se *shpenzimet e transferimit do të përballohen nga ana blerëse*. Referuar akteve noteriale dhe kontratës premtuese të shitjes, aktiviteti i shoqërisë “***” do të transferohet në shoqërinë e re dhe nga aksionerët e rinj (blerësit) dhe sipas parashikimeve të legjislacionit²⁰ parashikohet shlyerja e taksës 3% (*tasse di cessione d’azienda*) për pasuritë e luajtshme dhe 9% për ato të paluajtshme.

29.6.9 Në datën 17.11.2023, bashkëshorti i subjektit ka lidhur një marrëveshje me institucionin e deklaramit të të dhënave të shoqërive (***) për shlyerjen e detyrimit në vonesë të mbartur nga viti 2004, kohë në të cilën është nënshkruar transferimi i aktivitetit, me detyrim fillestar 8,436.04 euro, për të cilën data e njoftimit ka qenë 30.5.2008 dhe detyrimi aktual (me interesa/kamata) është 15,490.63 euro. Ky detyrim është rënë dakord të shlyhet me këste, ku subjekti deklaron se kësti i parë është shlyer në datën 17.11.2023.

29.6.10 Nga hetimi rezultoi se bashkëshortit i subjektit i ka drejtuar disa kërkesa institucioneve bankare në shtetin italian, për nxjerrjen e ekstrakteve të llogarive bankare dhe *statement*-eve, përkatësisht të shtetasit B.V dhe shoqërisë “****” S.N.C., por për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar të ruajtjes së dokumenteve të kërkuara, këto të fundit nuk i janë vënë në dispozicion.

29.6.11 Komisioni në përfundim të hetimit konkludoi se pjesa takuese e personit të lidhur nga të ardhurat e përfituara nga shitja e shoqërisë “****” gjatë viteve 2004 – 2009 është 50%. Ndërkohë, lidhur me analizën nëse këto të ardhura konsiderohen si të ardhura të ligjshme, Komisioni çmoi se, pavarësisht faktit se këto të ardhura janë të provuara që vijnë nga një burim

¹⁸ Bashkëlidhur pyetësorit nr. 2 dhe deklaratës *Vetting*, aneks nr. 4/16, dosja ILDKPKI.

¹⁹ Përcjellë me pyetësorin nr. 2, faqja 6 e kontratës paraprake, pika 4.

²⁰ Faqja zyrtare e *agenzia entrate*: https://www.agenziaentrate.gov.it/port****

i ligjshëm, kontrata e shitjes, ato nuk janë përfshirë në analizën financiare, pasi rezulton e provuar se për këto të ardhura ka filluar pagimi i tatimeve gjatë procesit të rivlerësimit. Për sa më sipër, subjektit i ka kaluar barra e provës.

29.6.12 Subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës²¹ së provës, ndër të tjera, pretendoi se nuk është detyrë e saj të justifikojë burimet e ligjshme të bashkëshortit, për sa kohë nuk kanë qenë në kushtet e bashkësisë ligjore dhe nga ana e Komisionit nuk është pretenduar për të ardhura të krijuara në mënyrë të kundërligjshme²², si dhe provohet me dokumentacion të plotë ligjor dhe justifikues se bashkëshorti i ka krijuar këto të ardhura. Për sa i përket detyrimeve tatimore, nga dokumentacioni i depozituar, konkretisht kontrata noteriale datë 15.7.2004, shkruhet qartësisht se detyrimet tatimore janë paguar dhe ai nuk kishte si ta dinte që nuk ishin paguar, nisur nga fakti se bashkëshorti është larguar në vitin 2005 nga Italia, ndërkohë që detyrimet janë konstatuar nga shteti italian në vitin 2008. Ajo deklaroi se janë vënë në dijeni vetëm gjatë këtij procesi për këto detyrime dhe kanë filluar t'i paguajnë pavarësisht faktit që subjekti shprehet se kjo çështje nuk i përket juridiksionit të rivlerësimit, për sa kohë bëhet fjalë për tatime në shtetin italian, të cilat për më tepër nuk shuhën asnjëherë. Subjekti parashtron se bazuar në legjislacionin italian, tatimet mund të pagohen në çdo kohë, për sa kohë të ardhurat rezultojnë të jenë të deklaruara. Subjekti shpjegon se nuk është në asnjë nga kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Bazuar në orientimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, subjekti parashtron se këto të ardhura i plotësojnë të dyja kriteret: *Së pari*, rezulton e provuar bindshëm krijimi i këtyre të ardhurave. *Së dyti*, rezulton e provuar që subjekti nuk ka qenë në keqbesim, por as bashkëshorti i saj, pasi ajo nuk ka pasur dijeni në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore, pasi bëhet fjalë për të ardhura të krijuara para se ajo të lidhte martesë. Subjekti sjell në vëmendje gjithashtu vendimin Sevdari kundër Shqipërisë të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut, duke kërkuar që të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni të përfshihen në analizën financiare, pasi rezultojnë të provuara që ato janë përfituar nga ana e tij. Në lidhje me pjesët takuese të dy aksionerëve, subjekti shpjegon: *“Pavarësisht se në kontratë nuk është parashikuar ndarja në masën 50% secili, pasi nuk kishte si të specifikohet, duke qenë se bëhet fjalë për dy shoqëri tregtare dhe ishin marrëdhënie ndërmjet dy ortakëve, veprimet e kambialeve provojnë faktin se bashkëshorti im ka përfituar 80% të vlerës së shitjes së këtij aktiviteti”*.

Vlerësimi i Komisionit

29.7 Komisioni, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit dhe deklarimeve në seancë dëgjimore, çmon se:

- Rezulton e provuar se të ardhurat nga shitja e shoqërisë “****” janë të ardhura që vijnë nga burime të ligjshme, pra provohet ekzistenca në kohë reale e krijimit të tyre. Komisioni nuk ngriti dyshime që këto të ardhura vijnë nga kryerja e një veprimtarie të kundërligjshme.
- Lidhur me detyrimet tatimore të paguara mbi këto të ardhura, Komisioni vlerësoi se këto detyrime kanë filluar të pagohen gjatë procesit të rivlerësimit, pra jo në kohë reale. Trupi gjykues çmoi se nuk rezultoi e provuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë qenë në keqbesim, por nga ana tjetër nuk mund të përjashtojë faktin se këto të ardhura janë të deklaruara dhe detyrimi tatimor është një çështje kohe, së bashku me kamatëvonesat që vendosen sipas

²¹ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës.

²² Shihni pikën 24 të vendimit nr. 19/2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

ligjit dhe marrëveshjes me autoritetet tatimore. Në këtë rast është e provuar se nuk kemi të bëjmë me mosdeklarim të të ardhurave/evazion tatimor. Mospagimi i tatimeve në këtë rast nga bashkëshorti mund të konsiderohet si një pakujdesi apo paqartësi, duke qenë se në kontratë parashikohet që detyrimet janë të palës blerëse. Gjithashtu, nuk ka një provë se bashkëshorti është njoftuar në rrugë formale për këtë detyrim. Nga dokumentacioni rezulton se në vitin 2008 është bërë gjenerimi i detyrimit tatimor dhe jo njoftim i bashkëshortit të subjektit për këtë detyrim. Ky gjenerim nga sistemi është bërë para datës 29.9.2009, datë e lidhjes së martesës midis tyre.

- Lidhur me sjelljen e subjektit në raport me këtë detyrim, është e provuar se subjekti nuk ka qenë në keqbesim, pasi këto të ardhura janë krijuar në një kohë që bashkëshorti ka jetuar në Itali, kohë gjithashtu në të cilën ajo ende nuk kishte lidhur martesë (të cilën e kanë lidhur në datën 29.9.2009) dhe kishin një regjim financiar të ndarë. Gjithashtu, nuk rezultoi e provuar se subjekti ka pasur dijeni se për pasurinë e krijuar janë përdorur të ardhura, për të cilat nuk është paguar detyrimi tatimor. Ky qëndrim mbështetet edhe në jurisprudencën orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, konkretisht vendimi nr. 15/2021.

Trupi gjykues çmon se në rastin konkret këto të ardhura nuk i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Por, pavarësisht kësaj, në analizë të vlerësimit të mësipërm, në mungesë të keqbesimit të bashkëshortit, kohës së gjatë të krijimit të këtyre të ardhurave, para lidhjes së martesës, si dhe mungesës së keqbesimit nga ana e subjektit, pavarësisht se ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare, trupi gjykues çmon se duhet të vlerësohen jopenalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pavarësisht vlerës së këtyre të ardhurave. Këto fakte do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

29.8 Të ardhurat e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit nga paga gjatë kohës së emigracionit në shtetin italian

29.8.1 Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit²³ rezultoi e provuar se²⁴ bashkëshorti i subjektit ka hyrë në shtetin italian në datën 23.2.1992 dhe ka deklaruar pranë Agjencisë së të Ardhurave Tatimore për periudhën 1998 – 2005 të ardhura, të cilat janë në vlerën totale 37,423 euro. Në analizë të këtyre provave rezulton se të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimit të INSP Itali (Instituti i Sigurimeve Shoqërore) për periudhën 1996 – 2005 janë në vlerën totale 67,319 euro.

29.8.2 Komisioni kreu analizën financiare të të ardhurave të bashkëshortit dhe ka përfshirë të ardhurat e vërtetuara nga INSP për vitet 1996 – 1997 dhe 2005, me vërtetim të përcjellë nga subjekti.

29.8.3 Për sa i përket të ardhurave në periudhën 1998 – 2004, subjekti ka përcjellë një dokument, i cili përfaqëson të ardhura si *competene corrente*, të cilat të përkthyer nuk përbëjnë të ardhurën neto, por as atë bruto sipas legjislacionit tatimor italian. Pavarësisht kësaj, Komisioni, në analizë të faktit që kemi të bëjmë me një ndryshim në një vlerë të vogël, i ka përfshirë të gjitha në vlerë totale në analizën financiare.

²³ Përgjigja 6 në pyetësin nr. 2.

²⁴ Kartë identiteti nr. ***, datë 10.5.1999; lejen qëndrimi nr. ***, datë 9.6.2000; leje drejtimi e automjetit nr. ***, datë 26.5.1999; librezë përshtatshmërie shëndetësore nr. ***, datë 1.6.2000; leje qëndrimi nr. ***, datë 10.3.2006; kartë identiteti nr. ***, datë 11.3.2021.

29.8.4 Nga analiza financiare²⁵ rezultoi se bashkëshorti ka pasur mundësi të kursejë vlerën 36,185 euro me të ardhura të ligjshme gjatë qëndrimit të tij në shtetin italian, në periudhën 1996 – maj 2005.

29.9 Të ardhura e personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit nga aktmarrëveshja e shitjes së pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit, Vlorë

29.9.1 Nga hetimi rezultoi se në aktmarrëveshjen nr. *** rep., datë 1.2.1997, të lidhur midis bashkëshortit dhe shtetasit XH.B, parashikohej se këta të fundit investuan në makineri dhe ndërtimin e një punishteje vaji mbi truallin në pronësi të shtetasit XH.B, të ndodhur në P., Vlorë. Me anë të aktmarrëveshjes, bashkëshorti i subjektit heq dorë nga pronësia mbi këtë punishte, duke ia shitur pjesën e tij takuese shtetasit XH.B kundrejt çmimit 1,000,000 lekë dhe 30,000,000 lireta²⁶, rreth 2,178,000 lekë, ose në total vlera 3,178,000 lekë. Në këtë aktmarrëveshje noteri shprehet se shuma e mësipërme u dorëzua në dorë në prezencë të saj nga shitësi XH.B.

29.9.2 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provonte shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga shitja e punishtes së vajt, për të cilën sqaron se: *“...vlera e përcaktuar në marrëveshjen nr. ***, datë 1.2.1997, është pjesa takuese e shtetasit B.V mbi makineritë për prodhimin e vajt dhe materialet e ndërtimit të punishtes, pjesë që bashkëshorti u detyrua ta shiste për shkak të trazirave të vitit 1997... Pra, nuk rezulton dhe nuk është pretenduar që shtetasi B.V të ketë realizuar të ardhura nga ky aktivitet apo që në vlerën e shitjes të jetë përfshirë shitja e aktivitetit, fakt që do të passillte edhe detyrimin e tij për kryerjen e pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale sipas parashikimeve të ligjit nr. 7786, datë 27.1.1994”.*

29.9.3 Komisioni nuk e përfshiu shumën e mësipërme në analizën financiare, për shkak të mungesës së dokumentacionit që provon pagesën e detyrimeve tatimore. Sa më sipër, subjektit i kaloi barra e provës.

29.9.4 Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e saj, si dhe në seancën dëgjimore, pretendoi se²⁷ provohet se nga shitja e punishtes së vajt, shitje e realizuar përpara noterit me aktmarrëveshjen nr. ***, datë 1.2.1997, bashkëshorti ka përfituruar një shumë totale prej 3,381,700 lekësh (1,000,000 lekë plus 30,000,000 lira italiane), të cilat subjekti i ka llogaritur në 2,381,700 lekë, të konvertuara me kursin 0,079.39 sipas Bankës së Shqipërisë në datën që është kryer transaksioni. Ajo ka deklaruar se janë krijuar në një kohë shumë të largët nga martesa me bashkëshortin dhe pasuritë e deklaruara nga ana e tij janë kryer në vitin 2009. Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore, bashkëshorti nuk ka pasur detyrimin për të paguar, pasi nuk bëhet fjalë për një pasuri e cila është regjistruar pranë ASHK-së, me qëllim më pas detyrimin për pagimin e detyrimeve tatimore.

Vlerësimi i Komisionit

29.10 Komisioni, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit dhe deklarimeve në seancë dëgjimore, çmon se:

²⁵ Paraqitur në tabelën nr. 5 të rezultateve të hetimit.

²⁶ BOA kursi i këmbimit lireta/lekë = 72.600.

²⁷ Për më shumë referojuni prapësimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

- Rezulton e provuar se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit i ka përfiturar këto të ardhura, e provuar kjo me një dokument noterial të kohës së krijimit të këtyre të ardhurave. Në mungesë të dokumentimit të pagimit të tatimeve, Komisioni nuk i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare.
- Trupi gjykues çmon se në rastin konkret këto të ardhura nuk i plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Por, pavarësisht kësaj, në analizë të vlerësimit të mësipërm, kohës së gjatë të krijimit të këtyre të ardhurave, krijimit para lidhjes së martesës, si dhe mungesës së keqbesimit nga ana e subjektit, pavarësisht se ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare, trupi gjykues çmon se duhet të vlerësohen se nuk mund të jetë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pavarësisht vlerës së këtyre të ardhurave. Këto fakte do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

29.10.1 Gjatë hetimit Komisioni konstatoi nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit se në datën 20.5.2005 është çelur depozitë kursimi në Raiffeisen Bank²⁸, me vlerë 877,763 lekë, së cilës i është rritur vlera me depozitim *cash* nga subjekti i rivlerësimit, në shumën totale 1,407,000 lekë, në datën 5.8.2005. Kjo depozitë është mbajtur si e tillë deri në datën 4.4.2006, kur shuma totale e akumuluar prej 1,422,516 lekësh ose rreth 11,499 euro²⁹ është tërhequr prej znj. Mirela Mishgjoni. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit deklaroi në DIPP/2003: “*Depozitë kursimi, Banka e Kursimeve, vlera 400,000 lekë. Burimi: kursime*”.

29.10.2 Komisioni hartoi analizën financiare³⁰ të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1995 – 2002, për të hetuar mundësinë e saj për të kursyer vlerën 400,000 lekë, të deklaruar në DIPP/2003 si depozitë kursimi. Nga analiza rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të kursejë vlerën 400,000 lekë, të deklaruar në DIPP/2003.

29.10.3 Subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit parashtrioi se është e vërtetë që nuk ka deklaruar kursime *cash*, por kjo ka qenë një pakujdesi e saj, e cila ka ndodhur si pasojë e faktit që kishte disa vjet që ishte shkëputur si gjyqtare dhe e kanë njoftuar se duhet të bëjë një deklaram, pa shpjeguar saktësisht se si duhej të kryhej ky deklaram. Ajo deklaroi se pavarësisht kësaj pasaktësie, e ka deklaruar depozitën dhe është pikërisht kjo depozitë që është tërhequr dhe ka shërbyer për blerjen e apartamentit.

Vlerësimi i Komisionit

29.11 Komisioni në analizë të provave të administruara gjatë hetimit dhe deklarimeve në seancë dëgjimore, çmon se:

- Nga analiza financiare subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash* dhe rrjedhimisht edhe të llogarisë bankare.
- Kjo llogari bankare është mbyllur në datën 4.4.2006, e cila përkon me pagesën e dytë të apartamentit objekt analize.
- Subjekti nuk ka kryer asnjë investim tjetër gjatë kësaj periudhe, si dhe në mbështetje të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji³¹ vlerëson se pasaktësitë në deklaratimet periodike, të

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 17.3.2021, e Raiffeisen Bank.

²⁹ BOA kursi i këmbimit euro = lekë 123.703.

³⁰ Shihni tabelën nr. 7 të rezultateve të hetimit.

³¹ Vendimet nr. 33/2021, 37/2021, 27/2022 dhe 22/2022.

pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se kursimet *cash* të subjektit do të mbahen në konsideratë në analizë financiare në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

Analiza financiare e pagesave të kryera për pasurinë objekt shqyrtimi

29.12 Nga hetimi ka rezultuar se pagesat për blerjen e pasurisë apartament objekt shqyrtimi kanë qenë si vijon, të pasqyruara në tabelën nr. 4.

Tabela nr. 4

	Data e pagesës	Vlera
Banka Popullore	22.12.2005	25,000 euro
	3.5.2006	10,000 euro
	24.8.2006	19,000 euro
Mandatarkëtimi	5.6.2007	4,864 euro
	5.6.2007	236 euro ose 28,500 lekë
	2007	900 euro
Vlera totale		60,000 euro

29.12.1 Komisioni ka kryer një analizë financiare³² për blerjen e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, nga ku rezulton se kanë pasur pamundësi në kryerjen e pagesave të apartamentit me të ardhura të ligjshme në vlerën -3,626,738 lekë.

29.12.2 Për sa më sipër, subjektit i kaloi barra e provës. Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi përfshirjen e të ardhurave të trajtuara dhe të analizuara në pikat 29.6 dhe 29.9 të këtij vendimi.

Vlerësimi i Komisionit

29.13 Komisioni çmon se në vlerësimin e tij lidhur me pasojat e diferencës negative në krijimin e kësaj pasurie merr në konsideratë faktin se burimi i krijimit të saj janë të ardhurat e personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, të cilat edhe pse nuk kalojnë testin e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të jenë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pasi janë krijuar kohë më parë se ata të fillonin jetën bashkëshortore, janë të ardhura të provuara nëpërmjet akteve noteriale, nuk janë produkt i një veprimtarie të paligjshme, si dhe subjekti nuk ka qenë në dijeni të përdorimit të të ardhurave, për të cilat nuk ishin shlyer detyrimet tatimore. Për pasojë, kjo pamundësi do të vlerësohet në vlerësimin tërësor të pasurisë.

30. Depozitë në Credins Bank³³, krijuar në datën 9.6.2008 e në vazhdim. Vlera: 3,939,019.99 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti si shef kuzhine i bashkëshortit, aktiviteti si avokate i deklarueses, ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë 16.7.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Strasburgut datë

³² Shihni tabelën nr. 8 të rezultateve të hetimit.

³³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: konfirmim nr. *** prot., datë 24.1.2017, lëshuar nga Credins Bank; nxjerrje llogarie për periudhën 9.1.2015 – 24.1.2017; librezë depozite e lëshuar nga Credins Bank; vendim nr. ***, datë 16.7.2010, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë; Fletore Zyrtare nr. 72 ekstra, janar 2011, në të cilën është publikuar vendimi i GJEDNJ-së për çështjen nr. 18381/05, Mishgjoni kundër Shqipërisë; Fletore Zyrtare nr. 56, datë 12.5.2011, në të cilën është publikuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. ***, datë 6.4.2011, për ekzekutimin e vendimit të çështjes nr. 18381/05, Mishgjoni kundër Shqipërisë.

7.12.2010 dhe interesa bankarë në vite. Personi i lidhur deklaroi në deklaratën *Vetting*: “Depozitë kursimi pranë Credins Bank, me vlerë 3,939,019.99 lekë”.

30.1 Duke qenë se nga hetimi, në analizë të transaksioneve bankare dhe dokumentacionit bankar, ka rezultuar se në vitin 2015 janë krijuar dy depozita me të njëjtën vlerë në emër të secilit prej tyre, të cilat kanë të njëjtën burim krijimi depozitën e mësipërme, janë trajtuar së bashku në vijim.

Hetimi³⁴/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

30.2 Nga hetimi i llogarisë së depozitës pranë Credins Bank³⁵ rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë hapur një llogari depozite³⁶ dyemërore në datën 9.6.2008 nga derdhja *cash* e shumës 500,000 lekë dhe në datën 10.12.2008 shtohet edhe shuma 500,000 lekë të tjera nga depozitimi i kryer prej subjektit të rivlerësimit. Në datën 11.6.2009, subjekti ka depozituar edhe 500,000 lekë të tjera. Gjatë periudhës në vazhdim, deri në datën 26.2.2013, vlera e depozitës shtohet vetëm nga interesat e akumuluar.

30.3 Në datën 26.2.2013, subjekti depoziton³⁷ vlerën 2,726,000 lekë, me përshkrimin “Sa derdh Mirela Mishgjoni të ardhura nga gjyqi i fituar”. Komisioni konstatoi se po në këtë datë subjekti tërheq vlerën 2,726,900 lekë nga llogaria e saj në Raiffeisen Bank³⁸, e cila i ishte transferuar në këtë llogari në datat 26.12.2012 dhe 23.11.2011, me përshkrimin “Vendime gjyqësore”³⁹.

30.4 Në datën 27.12.2013 ka depozituar shumën 432,000 lekë në llogarinë e depozitës së kursimit, e cila rezulton të ketë burim vlerën e mësipërme të transferuar në llogarinë e subjektit në Raiffeisen Bank dhe të tërhequr prej saj në datën 27.12.2013.

30.5 Në vitin 2015, subjekti depoziton shumën 2,354,500 lekë, me përshkrimin “Sa derdh në depozitë Mirela Mishgjoni të ardhura nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor”. Rezulton se në datën 24.6.2014 në llogarinë e subjektit pranë Raiffeisen Bank është transferuar shuma 1,702,027 lekë, me përshkrimin “Vendim gjyqësor”, e cila është tërhequr në datën 9.1.2015. Ndërsa në llogarinë e subjektit të rivlerësimit pranë Tirana Bank⁴⁰ rezulton se në datën 10.12.2013 i është transferuar shuma 655,180 lekë nga Ministria e Financave për vendimet gjyqësore⁴¹. Kjo shumë është mbajtur si depozitë kursimi deri në datën 9.1.2015 dhe më pas është tërhequr *cash* nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, në datën 10.1.2015 depoziton *cash* edhe shumën 25,600 lekë.

30.6 Në datën 10.1.2015, subjekti ka transferuar shumën 3,700,000 lekë në depozitën e kursimit në emër të bashkëshortit dhe pjesën e mbetur prej 3,700,000 lekësh e ka investuar në depozitë kursimi në emër të saj. Vlera e depozitës së kursimit shtohet nga interesat e akumuluar

³⁴Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.4.2021, e Credins Bank.

³⁵Shkresë nr. *** prot., datë 9.4.2021, e Credins Bank.

³⁶Llogaria nr. ***.

³⁷Llogaria nr. ***.

³⁸Shkresë nr. *** prot., datë 17.3.2021, e Raiffeisen Bank.

³⁹Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting*: (i) vendim nr. *** , datë 16.7.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila ka vendosur detyrimin e të paditurit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, t’i paguajë palës paditëse, shtetases Mirela Mishgjoni, pagën dhe sigurimet shoqërore për periudhën 12.1.2002 – 1.3.2009. Vendimi ka marrë formën e prerë me vendimin nr. *** , datë 3.5.2011, të Gjykatës së Apelit Vlorë; (ii) Fletore Zyrtare nr. 56, datë 12.5.2011, në të cilën është publikuar VKM-ja nr. 282, datë 6.4.2011, për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së datë 7.12.2010, për çështjen nr. 18381/05, Mishgjoni kundër Shqipërisë.

⁴⁰Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2021, e Tirana Bank.

⁴¹Referojuni botimeve në Fletoren Zyrtare dhe kopjeve të vendimeve gjyqësore përcjellë nga subjekti.

gjatë periudhës 2015 – 2017 dhe në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* shuma arrin në 3,939,019.99 lekë, në përputhje me sa ka deklaruar subjekti në deklaratën e pasurisë.

30.7 Vlera 3,700,000 lekë, e transferuar në llogarinë e bashkëshortit në datën 10.1.2015, është mbajtur prej tij si depozitë kursimi deri në datën 18.4.2017, kur kjo shumë ritransferohet në llogarinë e përbashkët dyemërore të znj. Mirela Mishgjoni dhe z. B.V. Po në datën 18.4.2017 z. B.V transferon shumën 1,887,300 lekë nga llogaria e tij në BKT⁴², e cila ka si burim transfertën e kryer në datën 23.6.2016, me përshkrimin “S.H kalon për B.V pagesë për blerje apartamenti nga D.L për shitësit Y.V dhe XH.V sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.5.2016 dhe prokurës bashkëngjitur”. Gjithashtu, në datën 18.4.2017 është transferuar vlera 239,020 lekë nga llogaria në të cilën akumuloheshin interesat e depozitës së kursimit. Pra, kjo vlerë përbën shumën e interesave bankarë të depozitës së kursimit. Në datën 31.12.2017, vlera e depozitës së kursimit pranë Credins Bank rezulton të jetë në total 9,765,339.98 lekë.

30.8 Vlera e depozitës së kursimit dhe interesat e saj⁴³ deri në datën 17.6.2020, së bashku me transfertat nga llogaritë e z. B.V si person fizik⁴⁴ dhe me vlerën nga transfertat e shumës së depozitës së kursimit të tij në monedhën euro⁴⁵ pranë Credins Bank dhe transfertat e vlerës 2,170,000 lekë së gjendjes së llogarisë së pagës pranë Tirana Bank të subjektit të rivlerësimit, transferohet në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. për blerje pasurie të paluajtshme në datën 18.6.2020, në total transferuar vlera 13,667,500 lekë.

30.9 Në analizë të burimit të ligjshëm rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përdorur për burimin e krijimit të depozitës së kursimit kryesisht të ardhurat nga vendimet gjyqësore të saj, të cilat janë përfituar gjatë viteve 2011 – 2014, me vlerë totale 5,516,235 lekë dhe i janë transferuar në llogarinë e saj pranë Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank. Subjekti përcjell me pyetësin nr. 2 vendimin nr. ***, datë 16.7.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Strasburgut datë 7.12.2010, me anë të të cilëve provohet burimi i krijimit të transfertave.

30.10 Gjatë hetimit u konstatua se vlera e depozituar në vitin 2008 është në total 1,000,000 lekë dhe referuar deklaratimeve të subjektit në DIPFD/2008 ka si burim “Të ardhura nga aktiviteti si shef kuzhine i bashkëshortit dhe aktiviteti si avokate”.

30.11 Nga hetimi rezultoi gjithashtu se shuma e të ardhurave të ligjshme të realizuara vetëm nga subjekti gjatë vitit 2008 nga aktiviteti i avokatisë është 2,000,000 lekë. Ndërkohë, shtesa në datën 11.6.2009, në vlerën 500,000 lekë të tjera, e depozituar nga subjekti, rezultoi me burime të ligjshme nga analiza financiare e kryer nga Komisioni. Gjithashtu, Komisioni ka hartuar tabelën e mëposhtme përmbledhëse të krijimit të depozitës së kursimit dhe burimeve të saj.

Tabela nr. 5 (vlerat në lekë)

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 17.3.2021, e BKT-së.

⁴³ Vlera e tyre për 3 vjet depozitë kursimi ka qenë 747,529.43 lekë.

⁴⁴ Transferohet nga llogaria “B.V”, person fizik, vlera 376,100 lekë.

⁴⁵ Kjo depozitë është krijuar në datën 20.7.2016 pranë Credins Bank. Vlera e transferuar në datën 18.6.2020 është 4,927.56 euro ose 608,553.66 lekë.

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shuma e depozituar	1,000,000	500,000				3,158,000		2,380,100	
Shuma e tërhequr		292,000							
Interesat bankare	13,500	79,214	80,818	72,409	76,993	156,619	174,440		239,235
Burimi i krijimit	Të ardhura nga aktiviteti si restorator i bsh dhe avokatia					Vendime gjyqate te transferuar në RBAL bank		Vendime gjyqate te transferuar në RBAL dhe Tirana bank	
Balanca e depozitës se kursimit në fund të vitit	1,013,500	1,300,714	1,381,532	1,453,941	1,530,934	4,845,554	5,019,994	7,400,094	7,639,329

Vlerësimi i Komisionit

30.12 Në përfundim të hetimit, nuk lindën dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

31. Tokë bujqësore me sip. 1,300 m², në N., Vlorë. Pjesa takuese: 20%. Burimi i krijimit: Ligji nr. 7501, datë 19.7.1991.

Hetimi⁴⁶/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

31.1 Babai i subjektit, në cilësinë e kryefamiljarit, ka përfituar me AMTP-në nr. ***, datë 3.5.2000, tokë bujqësore arë me sip. 1,300 m².

31.2 ASHK Vlorë konfirmon pasurinë tokë arë nr.***, me sip. 1,300 m², e ndodhur në z. k. ***, N, Vlorë, në pronësi të shtetasit S.M, e cila është përfituar sipas AMTP-së nr. ***. Nga hetimi nuk rezultuan ndërtime apo investime në këtë pasuri.

Vlerësimi i Komisionit

31.3 Në përfundim të hetimit, nuk lindën dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

32. Automjet⁴⁷ tip “Daimler Chrysler C270 CDI”, blerë në datën 24.6.2009. Vlera: 9,100 euro. Detyrimi doganor: 479,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Të ardhurat e kursyera gjatë viteve, të cilat i janë dhënë hua motrës së subjektit, znj. E.G, në vitin 2008 dhe kthyer prej saj në vitin 2009.

Hetimi⁴⁸/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

32.1 Nga hetimi rezultoi se në datën 24.6.2009, me kontratë të lidhur në gjuhën gjermane, rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë blerë automjetin tip “Mercedes-Benz C270”, për shumën 9,100 euro. Bazuar në deklaratën doganore ***, datë 27.6.2009, detyrimet doganore janë në vlerën 477,527 lekë. Këto detyrime provohen se janë paguar nga bashkëshorti i subjektit, i cili me mandatpagesën e datës 26.6.2009 në Intesa Sanpaolo Bank rezulton se ka paguar shumën 479,000 lekë⁴⁹.

32.2 Nga hetimi rezultoi se me deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.3.2009, nënshkruar nga subjekti dhe shtetasja E.G (M), deklarohet se kanë hyrë në një marrëdhënie huaje, pasi znj.

⁴⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës certifikatë pronësie datë 26.6.2003.

⁴⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: certifikatë pronësie për automjetin tip “Daimler Chrysler”; vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, lëshuar nga DPSHTRR, Drejtoria Rajonale Vlorë; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.3.2009; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.3.2015.

⁴⁸ Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 18.3.2021, e DPSHTRR-së.

⁴⁹ Kthim përgjigje e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 3.8.2017 sipas dosjes së ILDKPKI.

Mirela Mishgjoni i ka dhënë motrës së saj E.G (M) shumën 17,000 euro, në datën 12.7.2008, me qëllim rikonstruksionin e banesës së kësaj të fundit. Huaja është në mirëbesim, pa interes dhe shlyerja do të kryhet sipas mundësive të huamarrëses. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.3.2015, nënshkruar nga subjekti dhe shtetasja E.G (M), deklarohet se shuma 17,000 euro, e dhënë hua nga znj. Mirela Mishgjoni në datën 12.7.2008, është likuiduar në qershor të vitit 2009 nga shtetasja E.G (M).

32.3 Subjekti e ka deklaruar në DIPP/2009 këtë hua, por nuk ka deklaruar shlyerjen e saj, duke shkaktuar një pasaktësi në këtë deklaram periodik, të cilin e ka saktësuar në procesverbalin e datës 24.2.2015 pranë ILDKPKI-së⁵⁰. Në këtë procesverbal ajo ka deklaruar se paratë i ka marrë në vitin 2009 dhe i ka përdorur për blerjen e automjetit në atë vit dhe për nevoja të ndryshme.

Lidhur me burimin e krijimit

32.4 Subjekti deklaron në deklaratën *Vetting* se si burim i të ardhurave për dhënien e shumë hua motrës së saj E.G kanë shërbyer “Të ardhurat e kursyera gjatë viteve nga avokatia dhe të bashkëshortit si shef kuzhine”. Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit dhe bashkëshortit deri në datën e dhënies së huas, 12.7.2008, nga e cila rezultoi se vlera 17,000 euro, e kthyer nga motra e subjektit, është e mjaftueshme për të blerë automjetin në vlerën totale rreth 12,592.51 euro (9,100 euro + 479,000 lekë), por nga analiza e Komisionit rezultoi se subjekti kishte pamundësi (në vlerën totale të huas 17,000 euro ose 2,094,103 lekë) të jepte këtë shumë hua me të ardhura të ligjshme.

32.5 Për sa më sipër, subjektit i kaloi barra e provës. Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi përfshirjen e të ardhurave të trajtuara dhe të analizuara në pikat 29.6 dhe 29.9 të këtij vendimi.

Vlerësimi i Komisionit

32.6 Komisioni çmon se, në vlerësimin e tij lidhur me pasojat e diferencës negative në krijimin e kësaj pasurie, merr në konsideratë faktin se burimi i krijimit të saj janë të ardhurat e personit të lidhur, të cilat edhe pse nuk kalojnë testin e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nuk mund të jenë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pasi janë krijuar kohë më parë se ata të fillonin jetën bashkëshortore, janë të ardhura të provuara nëpërmjet akteve noteriale, nuk janë produkt i një veprimtarie të paligjshme, si dhe subjekti nuk ka qenë në dijeni të përdorimit të të ardhurave për të cilat nuk ishin shlyer detyrimet tatimore. Për pasojë, kjo pamundësi do të vlerësohet në vlerësimin tërësor të pasurisë.

33. Automjet tip “Daimler Chrysler”⁵², me targë ***, vjedhur në datën 16.12.2014. Vlera: 5.000 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Blerë me kontratën nr. ***, datë 1.4.2011, me të ardhurat e përfituara nga shitja e një automjeti në datën 8.7.2010.

Hetimi⁵³/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

33.1 Subjekti, së bashku me bashkëshortin e saj/personin e lidhur, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 1.4.2011, kanë blerë automjetin tip “Daimler Chrysler”, në shumën 5,000 euro.

⁵⁰ Shihni kthim përgjigjen nr. *** prot., datë 12.3.2021, të ILDKPKI-së.

⁵¹ BOA kursi i këmbimit lekë/euro 137.17.

⁵² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: certifikatë pronësie për automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targë ***, kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.4.2011; vërtetim nr. *** prot., datë 28.10.2016, lëshuar nga DPSHTRR, Drejtoria Rajonale Vlorë; vërtetim datë 24.3.2016, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁵³ Kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.3.2021, e DPSHTRR-së.

Bazuar në deklaratën doganore ***, datë 4.3.2011, rezulton se automjeti është blerë nga shitësi për shumën 3,450 euro dhe janë paguar detyrime tatimore në shumën 328,456 lekë.

33.2 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vërtetimin datë 24.3.2016 konfirmon se është regjistruar procedimi penal nr. ***, pasi në datën 21.12.2014 është denoncuar i vjedhur automjeti me targë ***, pronë e shtetasit B.V. Kjo çështje është pezulluar në datën 19.5.2015 dhe materialet i janë dërguar Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë për hetime të mëtejshme për zbulimin e autorëve.

Lidhur me burimin e krijimit

33.3 Subjekti deklaron në deklaratën *Vetting* si burim krijimi: “*Blerë me kontratën nr. ***, datë 1.4.2011, me të ardhurat e përfituara nga shitja e një automjeti në datën 8.7.2010*”.

33.4 Komisioni konstaton se në DIPP/2010 subjekti deklaron shitjen e automjetit në datën 8.7.2010, me vlerë 900,000 lekë, por nuk deklaron shtesë në likuiditete *cash* nga shitja e këtij automjeti në këtë deklaram.

33.5 Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka deklaruar se është pakujdesi që nuk e ka deklaruar si shtesë në *cash*, pasi mendonte se deklarimi i shitjes dhe mospërdorimi si burim për blerje të tjera pasurish konsiderohej si gjendje *cash*. Për më tepër, deri në prill të vitit 2011 subjekti deklaron se nuk ka shtuar pasuri të tjera.

33.6 Komisioni, duke mos e konsideruar këtë shume si gjendje *cash*, nuk e ka përfshirë si burim në analizën financiare e, për pasojë, i ka kaluar subjektit barrën e provës. Duket se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë këtë automjet, duke rezultuar me balancë negative prej 502,887 lekësh, analizë kjo e kryer për periudhën 1.1.2011 – 1.4.2011.

33.7 Pas kalimit të barrës së provës subjekti mbajti të njëjtin qëndrim, duke shtuar se në DIPP/2011 ka deklaruar si burim këto të ardhura për krijimin e kësaj pasurie.

Vlerësimi i Komisionit

33.8 Komisioni, në vlerësim të provave dhe fakteve, çmon se subjekti nuk gjendet në kushtet e një pretendimi të krijimit të gjendjes *cash* në banesë, bazuar thjesht në mundësitë hipotetike financiare sipas analizave financiare. Në këtë rast është e qartë se të ardhurat janë të provuara që rrjedhin nga shitja e automjetit, si dhe janë të papërdorura për ndonjë destinacion alternativ. Në DPV/2011, një vit më pas shitjes së automjetit, këto të ardhura janë deklaruar si burim për blerjen e automjetit në vitin 2011. Subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe para ILDKPKI-së. Në të njëjtën kohë edhe analiza financiare për vitin 2010 ka një balancë pozitive, në vlerën 958,795 lekë. Sa më sipër, Komisioni, në bazë të parimit të objektivitetit, vlerëson se këto burime nuk mund të injorohen nga prej tij, pasi penalizimi i subjektit thjesht për faktin e mosdeklarimit me korrektësi për shtimin apo pakësimin e gjendjes *cash* ndër vite, në rrethanat konkrete, do të ishte joproporcional. Ky vlerësim është në përputhje me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁵⁴. Komisioni çmon se pasaktësitë në deklaramet periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi. Për më tepër, këto pasaktësi janë korrigjuar nga subjekti menjëherë në deklaratën periodike të vitit 2011, por edhe pranë organit përgjegjës. Komisioni do të përfshijë

⁵⁴ Vendimet nr.33/2021, 37/2021, 27/2022 dhe 22/2022.

në analizë financiare të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit. Për pasojë, Komisioni çmon se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

34. Automjet tip “Daimler Chrysler A160 CDI”⁵⁵, me targë *, blerë në datën 22.1.2008 dhe shitur më 8.7.2010. Vlera: 500,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti si avokate dhe aktiviteti shef kuzhine i bashkëshortit.**

Konstatimi i ILDKPKI-së: *Rezulton se automjeti me targë ***, i blerë në vitin 2008 në shumën 500,000 lekë, të jetë shitur në vitin 2010 në vlerën 900,000 lekë.*

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

34.1 Subjekti dhe bashkëshorti i saj, me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 22.1.2008, kanë blerë automjetit tip “Daimler Chrysler”, në shumën 500,000 lekë. Ky automjet është shitur me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.7.2010, në shumën 900,000 lekë. Nga verifikimi i deklaratës doganore ***, datë 3.8.2007, rezulton se ky automjet është blerë nga shitësi në shumën 1,950 euro (237,568 lekë⁵⁶) dhe janë paguar detyrimet tatimore në vlerën 206,945 lekë.

34.2 Në lidhje me shitjen e automjetit në një vlerë më të madhe se çmimi i blerjes, subjekti ka sqaruar se ky ka qenë automjeti i dytë i familjes dhe është blerë në rrethana, të cilat shitësi ishte në kushtet e domosdoshmërisë për ta shitur dhe, si i tillë, ishte një okazion për ta blerë dhe për ta shitur më pas me një vlerë më të lartë.

34.3 Duke qenë se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion se vlera më e lartë e shitjes së automjetit kundrejt vlerës së blerjes vjen për shkak të kryerjes së shpenzimeve të mirëmbajtjes, të cilat e kanë përmirësuar gjendjen e tij në analizën e Komisionit, vlera e shitjes është pasqyruar sa vlera e blerjes, në përputhje me praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit.

34.4 Në lidhje me burimin e krijimit referuar deklaramentit të subjektit, rezulton se kjo pasuri është blerë me të ardhurat nga aktiviteti si avokate dhe aktiviteti shef kuzhine i bashkëshortit. Komisioni, në vijim të trajtimit të pasurisë apartament, hartoi analizën financiare të viteve 2005 – 2007, nga e cila rezultoi se deri në datën 31.12.2007 subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi kursimi deri në këtë periudhë, nga ku rezulton se ata nuk mund të kenë pasur mundësi të blejnë me të ardhura të ligjshme automjetin me vlerë 500,000 lekë, në datën 22.1.2008. Sa më sipër, duket se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për të blerë automjetin me vlerë 500,000 lekë.

34.5 Subjekti pas kalimit të barrës së provës⁵⁷ pretendoi se në analizën financiare të Komisionit duhet të merret në konsideratë çmimi i shitjes së automjetit, duke marrë në konsideratë faktin se automjeti është blerë në kushtet e domosdoshmërisë për ta shitur dhe është shitur nga subjekti dhe bashkëshorti pasi ishte një makinë e dytë dhe në gjendje shumë të mirë, pasi ishte përdorur prej tyre shumë rrallë. Subjekti pretendoi gjithashtu përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të deklaruara si burim ato të bashkëshortit dhe të ardhurat e saj.

34.6 Subjekti dha të njëjtat shpjegime edhe në seancën dëgjimore.

Vlerësimi i Komisionit

⁵⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.7.2023, e DPSHTRR-së; certifikatë pronësie për automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targë ***, kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.1.2008; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.7.2010.

⁵⁶ Kursi i këmbimit 121.830 sipas deklaratës doganore Import 4.

⁵⁷ Për më shumë referojuni prapësimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

34.7 Komisioni, në vlerësim të provave dhe fakteve, çmon se si burim në krijimin e kësaj pasurie të marrë në konsideratë vetëm vlerën e blerjes 500,000 lekë dhe jo 900,000 lekë. Ndërsa, për sa i përket burimit të ligjshëm të të ardhurave, Komisioni çmon se në vlerësimin e tij lidhur me pasojat e diferencës negative në krijimin e kësaj pasurie merr në konsideratë faktin se burimi i krijimit të saj janë të ardhurat e personit të lidhur, të cilat janë analizuar në pasuritë e vlerësuara si më sipër. Për pasojë, kjo pamundësi do të vlerësohet në vlerësimin tërësor të pasurisë, ashtu si edhe të gjitha pasuritë e krijuara deri në vitin 2009.

DEKLARIMI I PASURIVE TË BASHKËSHORTIT

35. Apartament banimi⁵⁸ me sip. 65 m², lagjja “**”, Vlorë, blerë në datën 15.11.1994. Vlera: 10,801 lekë. Pjesa takuese: 33.3%. Burimi i krijimit: Kontratë privatizimi.**

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

35.1 Nga hetimi rezultoi e provuar se babai i personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, me kontratë privatizimi nr. ***, datë 16.11.1994, ka blerë apartamentin 1+1, me sip. 65 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, Vlorë, për shumën 10,801 lekë, në pronësi të shtetasve M.V, N.V dhe B.V, me nga 1/3 pjesë takuese.

Vlerësimi i Komisionit

35.2 Komisioni vlerëson se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin.

36. Personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* sipërfaqet tokë arë, të ndodhura në R, Vlorë, përkatësisht:

- **Tokë bujqësore me sip. 4,560 m²**, në R, Vlorë, blerë me kontratën nr. ***, datë 16.4.2012. Vlera: 273,600 lekë.
- **Tokë bujqësore⁵⁹ me sip. 4,300 m²**, në R, Vlorë, blerë me kontratën nr. ***, datë 16.4.2012. Vlera: 258,000 lekë.
- **Tokë bujqësore⁶⁰ me sip. 1,000 m²**, në R, Vlorë, blerë me kontratën nr. ***, datë 16.3.2010. Vlera: 60,000 lekë.
- **Tokë bujqësore⁶¹ me sip. 2,500 m²**, në R, Vlorë, blerë me kontratën nr. ***, datë 16.3.2010. Vlera: 150,000 lekë. Pjesa takuese e deklaruar është 100% dhe burimi i krijimit për këto pasuri të paluajtshme janë kursimet.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

36.1 Nga hetimi ka rezultuar se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka lidhur disa kontrata shitblerjeje me palë shitëse shtetasit H.H e E.H dhe familja XH, të cilëve me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi u ishte njohur e drejta e pronësisë mbi këto prona, tokë arë dhe ullishtë, por që ende nuk i kishin të regjistruara në zyrën e regjistrimit. Me prokurë të posaçme, dhënë

⁵⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës certifikatë, kartela e pronësisë dhe hartë treguese, për pasurinë apartament nr. ***. Formular nr. 3, kontratë për privatizimin e banesës.

⁵⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës certifikatë, kartela e pronësisë dhe hartë treguese, për pasurinë tokë arë nr. ***, me sip. 4,300 m²; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.2012.

⁶⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës certifikatë, kartela e pronësisë dhe hartë treguese, për pasurinë tokë arë nr. ***, me sip. 1,000 m²; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.3.2010.

⁶¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës certifikatë, kartela e pronësisë dhe hartë treguese, për pasurinë tokë arë nr. ***, me sip. 2,500 m²; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.3.2010.

kunatit të subjektit (bashkëshortit të motrës), z. S.G, ky i fundit shfaqet në cilësinë e përfaqësuesit të tyre, me të drejta të plota. Në prokurat e administruara në dosjen hetimore parashikohet se shitësit deklarojnë se nuk kanë asnjë të drejtë mbi pasurinë objekt kontrate, pasi kanë marrë prej shtetasit S.G edhe vlerën e shitjes dhe kanë parashikuar gjithashtu që pala blerëse do të paguajë detyrimet për regjistrimin e këtyre pronave dhe detyrimin tatimor.

36.2 Në të gjitha kontratat çmimi i blerjes rezulton të jetë parashikuar në dy nivele, ai i blerjes dhe ai mbi të cilin është llogaritur detyrimi tatimor, pra çmimi i vlerësuar për efekt detyrimi tatimor. Nga dokumentacioni i administruar në ASHK pasuritë janë rivlerësuar pikërisht me çmimin e parashikuar në kontratë.

36.3 Gjatë hetimit subjekti⁶² ka dhënë shpjegime se *ka qenë bashkëshorti i motrës, i cili ka qenë vënë në dijeninë time nga një mik i tij se banorë të fshatit R. shisnin prona me çmim 50 lekë/m², për shkak se ishin toka bujqësore të paregjistruara dhe me vendndodhje me një distancë të konsiderueshme nga rruga kryesore dhe totalisht të painvestuar. Ajo shpjegon se në atë kohë kjo zonë nuk kishte plan zhvillimor dhe kishte një akses të kufizuar si me qytetin ashtu edhe me bregdetin dhe kishte një interes shumë të ulët për blerje në këtë zonë. Ai kishte qëllim ushtrimin e një aktiviteti tregtar dhe i kërkoi bashkëshortit tim ndihmë për regjistrimin e tyre dhe asistencë. Në mënyrë që investimi i tij të mos shkonte dëm, kunati parashikoi në kontratë edhe likuidimin e çmimit për pronarët. Duke qenë se planet për të ushtruar aktivitet tregtar për kunatin rezultuan të pasuksesshme, ai i propozoi bashkëshortit për blerjen e tyre me një çmim 60 lekë/m² (ndërsa për tokën me sipërfaqe 3,200 m² me çmim 100 lekë/m²). Në lidhje me këtë çmim, ai vuri si kusht edhe pagimin e të gjitha detyrimeve tatimore, por edhe ato të regjistrimit. Pikërisht për këtë fakt të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga bashkëshorti i subjektit.*

36.4 Nga hetimi rezulton se subjekti ka depozituar si provë aplikimet për regjistrimin e këtyre pasurive, nga ku konstatohet se këto pasuri janë regjistruar për herë të parë nga bashkëshorti i saj, pagesat për të gjitha shpenzimet e regjistrimit, përfshirë edhe pagesën e tatimit në burim në vlerën 10%, janë paguar nga bashkëshorti i saj.

36.5 Në të njëjtën kohë, noterja pranë së cilës janë përpiluar kontratat e mësipërme referon se vlera e blerjes për secilën prej tyre është ajo e përcaktuar në kontratë dhe se në kohën e përpilimit të tyre ka qenë në fuqi Udhëzimi i përbashkët nr. 9, datë 26.2.2008, i ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë, sipas të cilit zyrat noteriale kishin detyrimin të vinin palët në dijeni të çmimit të referencës mbi të cilin do të paguheshin tatimet dhe ta pasqyronin atë në kontratë. Subjekti ka depozituar disa kontrata⁶³ tip, ku janë vendosur si çmimet reale të shitjes ashtu edhe çmimet minimale fiskale, të përcaktuara në udhëzimin e sipërcituar.

36.6 Lidhur me përdorimin e këtyre tokave, nga hetimi nuk rezultoi që në këtë zonë të kishte ndërtime dhe plan zhvillimi dhe tokat me sipërfaqe 1,000 m², 2,500 m² dhe 3,200 m² i janë dhënë në përdorim pa pagesë, me qëllim krijimin e një vreshti shtetasit A.B, në marrëdhënie

⁶² Shihni pyetësorët nr. 2 dhe 3.

⁶³ Kontratë nr. ***, datë 9.6.2010, në të cilën përcaktohet çmimi për efekt fiskal 8,400,000 lekë dhe çmimi i shitjes 6,000,000 lekë; kontratë nr. ***, datë 24.3.2010, në të cilën përcaktohet çmimi për efekt fiskal 4,432,575 lekë dhe çmimi i shitjes 0 (zero) lekë; kontratë nr. ***, datë 23.3.2010, në të cilën përcaktohet çmimi për efekt fiskal 4,077,969 lekë dhe çmimi i shitjes 0 (zero) lekë; kontratë nr. ***, datë 24.3.2010, në të cilën përcaktohet çmimi për efekt fiskal 3,812,014 lekë dhe çmimi i shitjes 0 (zero) lekë; kontratë nr. ***, datë 19.5.2010, në të cilën përcaktohet çmimi për efekt fiskal 23,920,000 lekë dhe çmimi i shitjes 10,500,000 lekë

shoqërore me bashkëshortin, i regjistruar si person fizik “A.B”, me NIPT ***, duke i dhënë 10% të prodhimit të verës bashkëshortit, kjo sipas deklarimeve të subjektit.

36.7 Lidhur me burimin e krijimit, duke qenë se subjekti ka deklaruar si burim kursime, nga analiza financiare e viteve 2010, 2011 dhe 2012 nuk rezultuan problematika, pra kjo pasuri është krijuar me burime të ligjshme.

36.8 Komisioni hetoi në lidhje me konfliktin e interesit⁶⁴ me shitësit e këtyre tokave bujqësore, nga ku rezultoi se subjekti ka gjykuar dy çështje, përkatësisht kërkesën e shtetasit H.H kundër shtetasit A (E) H, me objekt “Lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes me vendimin nr. ***, datë 1.12.2018” dhe kërkesën e shoqërisë “****” sh.p.k., me objekt “Lëshim urdhër ekzekutimi për kontratë kredie bankare nr. ***, datë 7.12.2018”, të lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit S.XH. Në të dyja rastet subjekti ka kërkuar heqjen dorë, kërkesë e cila nuk është pranuar nga kryetari i Gjykatës. Konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur në kërkesë shkakun e dorëheqjes në njërin prej tyre, ndërkohë në tjetrën, pavarësisht se e ka përmendur këtë fakt, kjo nuk është pranuar nga kryetari i Gjykatës.

36.9 Sa më sipër, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit vetëm në lidhje me çmimin e blerjes së parcelave të tokave të ndodhura në R, Vlorë, duke qenë se nga dokumentacioni i përcjellë rezultojnë çmime të ndryshme për të njëjtën pasuri, si dhe për mosdeklarimin e shkakut të dorëheqjes për një nga çështjet e gjykuara prej saj.

36.10 Subjekti mbajti të njëjtin qëndrim si edhe në parashtrimet e dhëna gjatë hetimit administrativ.

Vlerësimi i Komisionit

36.11 Komisioni, në vlerësim të të gjithë provave dhe fakteve të analizuara, çmon se nuk lindin dyshime lidhur me çmimin e parashikuar në kontratën e shitjes, i cili rezulton më i ulët se ai i referencës. *Së pari*, nga hetimi nuk rezultuan *indicie* për konflikt interesi me shitësit e tokave. *Së dyti*, çmimi i referencës është vendosur si një çmim për efekt llogaritjeje tatimi, e provuar kjo si një praktikë e noteres. *Së treti*, ekzistenca e kunatit të subjektit si përfaqësues i pronarëve të tokës nuk mund të jetë një element që të çon në një deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, mbi të cilin mund të ngrihen dyshime për vlerën reale të saj. Kunati ka marrë prokurat respektive kohë më parë se të lidheshin kontratat e shitjes, me përjashtim të njëres prej tyre. Kjo pronë ka qenë e pazhvilluar, e paregjistruar dhe nuk ka asnjë *indicie* që vlera reale e këtyre pronave nuk ka qenë sa ajo e shitjes, por ka qenë sa ajo e referencës fiskale apo edhe më shumë se referenca fiskale. Parashikimi i çmimit është dhënë në një kontratë, ku fuqia ligjore e saj është e bazuar ligjërisht dhe nuk mund të vihet në diskutim si e tillë. Lidhur me konfliktin e interesit, shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse dhe mosdeklarimi i shkakut të dorëheqjes nuk përbën fshehje, pasi fakti nuk përbën një nga shkaqet për dorëheqje, duke pasur gjithashtu parasysh që vendimmarrja është shumë kohë më pas lidhjes së kontratës së shitjes, bazuar kjo në ligjin nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e

⁶⁴ Subjekti ka depozituar: vërtetimin nr. ***, datë 21.7.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë; vendimin nr. ***, datë 1.12.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, së bashku me dosjen gjyqësore, pjesë e së cilës është edhe kërkesa për dorëheqje datë 29.11.2018; vendimin datë 30.11.2018, të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për mospranimin e kërkesës për dorëheqje; vendimin nr. ***, datë 6.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, së bashku me dosjen gjyqësore, pjesë e së cilës është edhe kërkesa për dorëheqje datë 22.11.2021; vendimin datë 2.12.2021, të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për mospranimin e kërkesës për dorëheqje.

funksioneve publike”, i ndryshuar, nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit⁶⁵.

36.12 Në përfundim, Komisioni çmon se këto pasuri janë deklaruar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e tyre.

37. Tokë bujqësore⁶⁶ me sip. 31,525 m², në M, Tiranë, blerë me kontratat nr. ***, datë 17.6.2011, nr. ***, datë 22.6.2011 dhe nr. ***, datë 22.11.2011. Vlera: 301 lekë/m². Vlera: 451,500 lekë. Pjesa takuese: 0.05%. Burimi i krijimit: Pjesa e mbetur e të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit në datën 8.7.2010 dhe të ardhura të kursyera.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

37.1 Rezulton se me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 17.6.2011, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit së bashku me 11 shtetas të tjerë ka blerë nga familja M⁶⁷ pasurinë tokë arë nr. ***, me sip. 10,000 m², e ndodhur në z. k. ***, M, Tiranë. Në kontratë përcaktohet se palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së kësaj sipërfaqeje tokë arë të jetë 301 lekë/m², në total 3,010,000 lekë, shumë e cila është shlyer jashtë zyrës noteriale. Bashkëshorti i subjektit ka blerë 5/100 pjesë takuese (150.500 lekë).

37.2 Gjatë hetimit subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit koordinatat e kësaj toke, ku parashtron se mbi të nuk ka asnjë investim apo ndërtim.

Lidhur me burimin e krijimit

37.3 Subjekti deklaron si burim krijimi: *“Me pjesën e mbetur të të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit në datën 8.7.2010 dhe të ardhura të kursyera”*. Në analizë të pasurisë së trajtuar në pikat 29.6 dhe 29.9 dhe të konkluzionit për të mos përfshirë si të ardhura të ligjshme çmimin e shitjes më të lartë se ai i blerjes, subjekti rezultoi me një balancë negative në vlerën totale të blerjes së kësaj prone. Subjektit i kaloi barra e provës.

37.4 Subjekti shpjegoi burimin e krijimit si në pasurinë e trajtuar në pikën 29 të vendimit.

37.5 Në përfundim, Komisioni çmon se këto pasuri janë deklaruar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e tyre.

38. Likuiditete cash në vlerën 10,000 euro (shuma e mbetur pas vjedhjes së banesës në datën 4.8.2016). Pjesa takuese: 100%. Vlera: 52,000 euro dhe 100,000 lekë, e vjedhur në datën 4.8.2016. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti privat dhe shitja e një restoranti të ndodhur në Itali në vitin 2004.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

38.1 Në referencë të provave të administruara, nga hetimi rezulton se subjekti dhe bashkëshorti fillojnë të deklarojnë likuiditete cash në këto vlera: në DIPP/2009, kursime dhe kambiale –

⁶⁵ Vendimet nr. 41/2002, nr. 21/2020 dhe nr. 42/2022.

⁶⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: certifikatë, kartela e pronësisë dhe harta treguese, për pasurinë tokë arë nr. ***, me sip. 10.000 m²; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.6.2011; certifikatë, kartela e pronësisë dhe harta treguese, për pasurinë tokë arë nr. ***, me sip. 7,000 m²; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.6.2011; certifikatë, kartela e pronësisë dhe harta treguese, për pasurinë tokë arë nr. ***, me sip. 14,525 m²; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.11.2011.

⁶⁷ Kryefamiljar A.M.

vlera 70,000 euro; në DIPP/2009 – 2012 nuk ka deklarim lidhur me gjendjen *cash*; në DIPP/2013 pakësuar kursimet në vlerën 8,000 euro; në DIPP/2014, subjekti deklaron gjendje *cash* në vlerën 600,000 lekë; në DIPP/2015 nuk ka deklarim dhe në DIPP/2016 deklaron: “Pakësuar likuiditeti *cash* (pas vjedhjes së banesës në datën 4.8.2016), në vlerën 52,000 euro”. Në datën 24.2.2015, përpara ILDKPKI-së⁶⁸ deklaron se ka gjendje *cash* shumën 62,000 euro në fund të vitit 2013, por edhe në momentin që është pyetur nga ky institucion.

38.2 Në referencë të vërtetimit datë 24.1.2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë konfirmohet regjistrimi i procedimit penal nr. ***, pas denoncimit në datën 4.8.2016 të vjedhjes së sendeve (varëse, unaza, materiale floriri), në vlerën rreth 500,000 lekë dhe shumave 52,000 euro e 100,000 lekë, në banesën pronë të shtetasit B.V, bashkëshorti i subjektit. Kjo çështje rezulton të jetë pezulluar në datën 28.12.2016, pasi autori i veprës penale nuk njihet dhe veprimet e mundshme janë kryer⁶⁹.

38.3 Pavarësisht se nga ky procedim provohet se subjektit i kanë vjedhur shumën 52,000 euro dhe 100,000 lekë, shumë e cila rezulton të jetë deklaruar nga subjekti si kursim *cash* që në vitin 2009, Komisioni ka analizuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj vlere, e cila faktikisht në deklaratën *Vetting* vjen në një vlerë prej 10,000 euro.

Lidhur me burimin e të ardhurave për krijimin e shumës 70,000 euro

38.4 Të ardhurat nga avokatia të subjektit të rivlerësimit

38.4.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga avokatia në shumën 6,000,000 lekë. Nga dokumentacioni i administruar nga Bashkia Vlorë⁷⁰ rezulton një qarkullim i deklaruar për vitet 2007 – 2009, në vlerën totale 9,000,000 lekë⁷¹, si dhe taksat vendore dhe për biznesin e vogël të shlyera prej saj gjatë kësaj periudhe. Vlerën e të ardhurave nga ushtrimi i veprimtarisë si avokate subjekti e ka deklaruar për herë të parë në DIPP/2009, në vlerën 590,000 lekë.

38.4.2 Nga hetimi⁷² rezulton se subjekti i rivlerësimit është regjistruar si person fizik me NIPT ***, në datën 9.5.2007. Sipas informacionit të dërguar nga Bashkia Vlorë⁷³, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit gjatë ushtrimit të aktivitetit si avokate janë pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 6

Viti	Qarkullimi i deklaruar	Taksa vendore dhe tatimi i biznesit të vogël (shkresa e Komisionit)	Fitimi pas taksave
2007	3,000,000 lekë	14,800 lekë	2,985,200 lekë
2008	4,000,000 lekë	79,500 lekë	3,920,500 lekë
2009	3,000,000 lekë	73,500 lekë	2,926,500 lekë
TOTALI	10,000,000 lekë	167,800 lekë	9,832,200 lekë

⁶⁸ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.3.2021, të ILDKPKI-së.

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 12.10.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, kopje të procedimit penal nr. ***.

⁷⁰ Dosja ILDKPKI, aneks nr. 4/7.

⁷¹ Qarkullimi i deklaruar: viti 2007 – 3,000,000 lekë; viti 2008 – 3,000,000 lekë; viti 2009 – 3,000,000 lekë.

⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 29.3.2021, e DPT-së, shkresë nr. *** prot., datë 31.3.2021, e QKB-së dhe faqja zyrtare e QKB-së

⁷³ Shkresë nr. *** prot., datë 21.8.2023, e Bashkisë Vlorë.

38.4.3 Nga hetimi rezulton se subjekti për vitet 2008 – 2009 nuk rezulton të ketë deklaruar xhiro mbi 2,000,000 lekë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe nuk vërtetohet pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për xhiron mbi 2,000,000 lekë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9844, datë 17.12.2007, i ndryshuar, neni 12, pika 1, ku thuhet se: *“Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të cilat realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8,000,000 lekë dhe jo më pak se 2,000,000 lekë janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale”*. Komisioni vëren se të ardhurat e subjektit nga aktiviteti i saj si avokate nuk mund të kapërcejnë pragun prej 2,000,000 lekësh për ato vite ku nuk vërtetohet pagesa e detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël nga organet tatimore.

38.4.4 Subjekti ka shpjeguar si gjatë procesit dhe në seancë dëgjimore se nga viti 2004 deri në vitin 2006, duke qenë se për shkak të mosveprimit të KLD-së nuk mund të ushtronte detyrën e gjyqtarit dhe nuk kishte asnjë të ardhur tjetër, e ka ushtruar profesionin e avokatit në mënyrë jo të përhershme, për shkak se ishte në pritje të marrjes në shqyrtim të çështjes nga ana e KLD-së. Pas kalimit të një kohe të gjatë dhe faktit që pavarësisht kërkesave të vazhdueshme, KLD-ja nuk merrte në shqyrtim çështjen, në datën 14.9.2006... Ndërsa për shlyerjen e detyrimeve tatimore, subjekti shpjegon se për sa i përket pagimit të detyrimeve tatimore ka paraqitur vërtetimin nr. ***, datë 26.7.2023, të Bashkisë Vlorë dhe vërtetimin nr. ***, datë 28.7.2023, të DRT-së Vlorë, sipas të cilëve rezulton se ajo nuk ka detyrime tatimore të papaguara, por cilëson që nisur nga fakti që kanë qenë kontabilistët që bëjnë pagesat, ajo vetë nuk ka pasur dijeni dhe nuk ka paguar personalisht tatime pranë organeve tatimore.

38.4.5 Sa më sipër, subjektit i kaloi barra e provës, duke e llogaritur fitimin neto me marzhin e fitimit 80% pas shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore. Për vitin 2008, e ardhura do të llogaritet 80% e shumës kufi 2,000,000 lekë, pasi nuk u provua pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale. Komisioni ka përfshirë në analizë të ardhurat nga avokatia për periudhën 2007 – 2009, në vlerën totale 4,578,160 lekë.

38.4.6 Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ndër të tjera⁷⁴, pretendoi se marzhi i fitimit duhet të llogaritet në masën 90%, kjo sipas praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁷⁵.

Vlerësimi i Komisionit

38.5 Në përfundim, Komisioni, në analizë të provave, shpjegimeve të subjektit, si dhe bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ka llogaritur marzhin e fitimit në masën 90%, duke arritur të përfshihet në analizë financiare të ardhura nga avokatia në vlerën 8,848,980 lekë.

38.6 *Të ardhurat e fituara nga bashkëshorti si shef kuzhine gjatë periudhës 2005 – 2011, shuma 5,400,000 lekë*

38.6.1 Subjekti, gjatë procesit lidhur me provueshmërinë e këtyre të ardhurave, ka deklaruar se nuk dispononte dokumentacion për pagesën e detyrimeve tatimore dhe se ky detyrim është i punëdhënësit. Ndërkohë që DIVA si një mundësi vetëdeklarimi është parashikuar më vonë në

⁷⁴ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

⁷⁵ Vendimet nr. 27/2023 dhe nr. 20/2023 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

kohë. Ajo ka depozituar disa deklarata noteriale dhënë nga punëdhënësit, përkatësisht shoqërisë “****” sh.p.k., të personit fizik “E.B”, si dhe të personit fizik “P.M”. Në këto deklarata ata deklarojnë faktin e punësimit të bashkëshortit të subjektit si kuzhinier në restorantet e tyre.

38.6.2 Subjekti, në vijim të procesit deklaroi se në lidhje me punësimin e bashkëshortit pranë personit fizik “E.B”; shoqëria “****” sh.p.k. dhe personi fizik “P.M”, bashkëshorti i saj ka ardhur në dijeni gjatë procesit të *Vetting*-ut të moskryerjes së detyrimeve ligjore nga këta punëdhënës, pra mospagimin e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale. Me ardhjen në dijeni bashkëshorti i subjektit ka kërkuar gjyqësisht që këta punëdhënës të zbatojnë detyrimet ligjore. Me vendimin nr. ***, datë 7.6.2023, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka vendosur detyrimin e punëdhënësve të paguajnë në favor të bashkëshortit sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Rezulton se ky vendim është ekzekutuar në mënyrë të detyrueshme nëpërmjet përmbarimit gjyqësor dhe, në përfundim të ekzekutimit, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 20.7.2023, ka informuar bashkëshortin për zbatimin tërësisht të detyrimeve të përcaktuara në vendimin gjyqësor.

38.6.3 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve, ka përfshirë në analizë të ardhurat nga paga të bashkëshortit për periudhën 2005 – 2010, për pagesa për punëdhënësit E.B dhe “****” sh.p.k., në total në vlerën 3,160,000 lekë. Në lidhje me të ardhurat e fituara nga subjekti “P.M” nga provat e përcjella nga subjekti rezultoi se detyrimet tatimore nuk ishin ende të shlyera. Për këtë arsye, Komisioni nuk i përfshiu në analizën financiare të ardhurat e fituara pranë këtij subjekti tregtar dhe për këtë subjektin i kaloi barra e provës.

38.6.4 Nga provat e administruara nga subjekti rezulton se me kërkesën nr. ***, datë 13.7.2023, Inspektori i Kontrollit të Drejtorisë Tatimore Rajonale Vlorë ka kërkuar të hapet çështje në sistemin C@TS për të bërë të mundur ndryshimin e deklaratës së tatimit në burim për subjektin “P.M” për periudhën korrik 2015. Me shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2023, është nxjerrë njoftim-vlerësimi për detyrimet, sipas të cilit z. M kishte detyrimin për të paguar në total shumën 554,808 lekë. Ky detyrim rezulton të jetë paguar në datën 14.7.2023, provuar nga mandatar-këtimi i lëshuar nga Credins Bank⁷⁶.

38.6.5 Në përfundim të hetimit, Komisioni kreu analizën financiare dhe i kaloi barrën e provës subjektit, ku duket se ka mospërputhje të vlerës së deklaruar *cash* në DIPP/2016 prej 884,580 lekësh me vlerën e deklaruar në deklaratën *Vetting* prej 10,000 euro ose 1,329,500 lekësh. Duket se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur pamundësi financiare për të krijuar gjendjen e kursimeve *cash* prej 70,000 euro (ose rreth 9,601,900 lekë) në vlerën totale të tyre, pra - 9,601,900 lekë, të deklaruar në DPDFD/2009.

38.6.6 Pas kalimit të barrës së provës subjekti pretendoi se⁷⁷: “Në lidhje me këtë barrë prove, ...gjatë këtij hetimi administrative kam provuar:

- i. të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi në Itali për periudhën 1996 – 2005, në vlerën 36,185 euro;
- ii. të ardhurat e bashkëshortit nga shitja e restorantit në Itali në vlerën 65,800 euro, sikurse pretendon Komisioni dhe në vlerën 104,000 euro (108,000 - 4,000), pra 80% të shumës, sikurse pretendohet nga ana ime;

⁷⁶ Përcjellë bashkëlidhur pyetësorit nr. 5.

⁷⁷ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

- iii. të ardhurat e përfituara nga shitja e pjesës takuese në fabrikën e përpunimit të ullirit, P, Vlorë, në vlerën 3,381,700 lekë;
- iv. të ardhurat nga llogaria bankare në vlerën 1,417,209 lekë;
- v. të ardhurat e përfituara nga bashkëpunimi me personin fizik “P.M”, në vlerën 3,250,000 lekë;
- vi. të ardhurat nga punësimi pranë personit fizik “E.B” dhe shoqëria “***”, sh.p.k., në vlerën 3,160,000 lekë;
- vii. të ardhurat e përfituara nga avokatia në shumën 6,000,000 lekë;
- viii. të ardhurat nga avokatia për periudhën 2004 – 2006 në vlerën 1,000,000 lekë”.

38.6.7 Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, shpjegoi⁷⁸ gjithashtu se: “U provua gjatë këtij hetimi administrativ se bashkëshorti ka ardhur në dijeni gjatë procesit të Vetting-ut të moskryerjes së detyrimeve tatimore nga personi fizik “P.M”, për rrjedhojë me ardhjen në dijeni të faktit ka kërkuar gjyqësisht që ky punëdhënës të zbatojë detyrimet ligjore. Marrëdhënia e bashkëpunimit midis tyre ishte e bazuar në honorare, personi fizik “P.M” nuk kishte detyrim të paguante sigurime shoqërore dhe shëndetësore, por ishte i detyruar të paguante vetëm tatimin mbi të ardhurat personale, pra 10% të shpërblimit që i jepte (shihni VKM-në nr. 1114, datë 30.7.2008 dhe Udhëzimin nr. 26, datë 16.4.2009, të DPT-së). Nga ana e DRT-së Vlorë, mbi këtë bazë janë llogaritur detyrimet për tatimin në burim dhe interesat ligjore. Shuma e detyrimit tatimor është llogaritur në masën 325,000 lekë kamatëvonesat në masën 158,633 lekë dhe gjobë për pagesë me vonesë në masën 71,175 lekë, veprim i cili gjendet në shkresën nr. 4968 prot., datë 13.7.2023 “Njoftim-vlerësimi për detyrimet”. Subjekti person fizik “P.M” ka paguar detyrimin e mësipërm në shumën 554,883 lekë. Me shkresën nr. *** prot., datë 20.7.2023, DRT-ja ka informuar bashkëshortin për zbatimin tërësisht të detyrimeve të përcaktuara në vendimin gjyqësor”.

Vlerësimi i Komisionit

38.7 Komisioni, në vlerësim të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se të ardhurat e bashkëshortit të deklaruar nga puna si shef guzhine në tri subjektet të përfshihet në analizën financiare.

38.8 Në analizë të ligjshmërisë së të ardhurave të bashkëshortit analiza fillon me vendimin e gjykatës, i cili parashikon detyrimin që kanë punëdhënësit ndaj bashkëshortit të subjektit. Ky vendim rezulton i ekzekutuar në mënyrë të vullnetshme nga punëdhënësit. Rezulton se vendimi i gjykatës është ekzekutuar sipas njoftimit për ekzekutim vullnetar nr. *** prot., nr. *** regj., datë 26.6.2023, përmbarues gjyqësor privat “E.V” dhe shkresë të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë⁷⁹, sipas së cilës nga verifikimet e kryera në sistemin C@TS ka rezultuar se DRT Vlorë ka ekzekutuar vendimin nr. ***, datë 7.6.2023. Gjithashtu, subjektet “****” sh.p.k., “E.B” dhe “P.M” kanë paguar të gjitha detyrimet në zbatim të vendimit nr. ***, datë 7.6.2023. Në një vlerësim të peshës që ka ky vendim në procesin e rivlerësimit është e qartë se ky është një vendim që ka dalë gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit, por ky nuk mund të jetë një vendim, i cili ka fuqi detyruese vetëm ndaj palëve në proces. Në kuadër të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe jurisprudencës së konsoliduar të

⁷⁸ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 20.7.2023.

Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁸⁰, përmbushja e elementeve të ligjshmërisë së të ardhurave nëpërmjet ekzekutimit të këtij vendimi, nuk mund të jetë i shkëputur nga disa fakte të tjera, të cilat rezultuan gjatë hetimit si:

38.8.1 Bashkëshorti i subjektit ka ushtruar profesionin e shefit të kuzhinës nga viti 1995 e në vijim.

38.8.2 Ai ka qenë në padijeni për mospërmbushjen nga punëdhënësi të pagesës së detyrimeve tatimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi masën e pagës së deklaruar nga personi i lidhur, e cila e përjashton atë nga të qenit në kushtet e keqbesimit në raport me sjelljen e palës punëdhënëse.

38.8.3 Bashkëshorti i subjektit, përveç faktit se ka punuar në subjektet e mësipërme, në të njëjtën periudhë është përpjekur të hapë një restorant të tij, fakt, i cili provohet me kontratë qiraje nr. ***, datë 16.10.2007, me palë qiradhënëse shtetasen L.D (B) dhe palë qiramarrëse shtetasit F.V e B.V, me objekt marrjen me qira të një lokali të ndodhur në lagjen “***”, me sip. 400 m², me afat 1.1.2007 – 1.11.2012, me të drejtë përsëritjeje.

38.8.4 Subjekti ka deklaruar të ardhurat e bashkëshortit në DIPP/2009 e në vijim si shef guzhine. Kjo provon faktin që këto të ardhura dhe kjo punë është kryer nga ana e personit të lidhur dhe nuk është një deklaram që lidhet me procesin e rivlerësimit.

38.8.5 Këto kursime nuk rezultojnë të jenë përdorur nga subjekti për blerjen e ndonjë pasurie për t’u ngritur dyshime për deklaram fiktiv.

38.8.6 Vlera e likuiditeteve *cash* e deklaruar në deklaratën *Vetting* është 10,000 euro, për të cilën nga analiza financiare rezultojnë se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e saj.

38.9 Për sa më sipër, Komisioni çmon se në analizën financiare të burimit të ligjshëm 70,000 euro në vitin 2009 janë të ardhurat nga shitja e aktivitetit të bashkëshortit në Itali, të cilat janë analizuar në pikën 29.6 të vendimit dhe që do të vlerësohen në tërësi lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë. Janë pikërisht këto të ardhura që pasqyrojnë pamjaftueshmërinë në analizën financiare, në vlerën totale të likuiditetit.

39. Bashkëshorti i subjektit deklaron marrëdhënie huadhënieje me shtetasit M dhe Y.V, të cilat i kthehen në formën e pasurive të mëposhtme:

- **Depozitë në Credins Bank⁸¹**, krijuar në datën 20.7.2016. Vlera: 9,004.38 euro. Pjesa takuese: 100%.
- **Llogari rrjedhëse në Credins Bank⁸²**, krijuar në datën 23.1.2017, pas transferimit të llogarisë nga Banka Kombëtare Tregtare, llogari e krijuar në datën 4.5.2016. Vlera: 1,887,300 lekë. Pjesa takuese: 100%.

⁸⁰ Shihni vendimet e Kolegjit nr. (JR) 15/2021, datë 18.6.2021, nr. (JR) 35/2022, datë 22.9.2022, nr. (JR) 4/2023 dhe nr. (JR) 26/2023.

⁸¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.7.2016; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.5.2016; urdhër xhirim datë 20.7.2016, i lëshuar nga Credins Bank; nxjerrje llogarie, e lëshuar nga Credins Bank.

⁸² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie, e lëshuar nga Credins Bank.

Burimi i krijimit për të dyja deklaratimet e mësipërme: Të ardhura të krijuara gjatë viteve të emigracionit, lënë në administrim shtetasit M.V dhe kthyer prej këtij të fundit.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

39.1 Subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 20.7.2016, të nënshkruar nga bashkëshorti i saj, babai i bashkëshortit, z. M.V, dhe vëllai i bashkëshortit të subjektit, z. Y.V, së bashku me bashkëshorten e tij, znj. XH.V. Në këtë akt deklarohet se z. Y.V, znj. XH.V dhe bashkëshorti i subjektit kanë qenë në emigrim në Itali dhe të gjitha kursimet e tyre nga emigrimi, ja kanë lënë në ruajtje në rast se do i duheshin për administrim M.V (babai i Y dhe B.V). M.V nga kursimet e dy djemve të tij duke marrë edhe aprovimin e shtetasit B.V i ka dhënë shumën 3,000,000 lekë shtetasit Y.V për qëllime shëndetësore dhe për shkollimin e fëmijëve. Në momentin që shtetasi B.V ka kërkuar t'i kthehen vlerat monetare, nga shtetasit Y dhe XH.V i është premtuar se një pjesë e detyrimit do t'i shlyheshin me shitjen e apartamenti nr. ***, me sip. 73 m², shitje e cila është realizuar në datën 26.5.2016. Nga vlera 2,300,000 lekë që do të kalonte në llogarinë e noterit për shitjen, është zbritur shuma 280,000 lekë, e cila ka qenë pjesa e pagesës për detyrimet për tatim-fitimin etj. dhe diferenca e mbetur është pjesë e borxhit të marrë ndaj shtetasit B.V. Në datën 11.7.2016, shtetasit Y dhe XH.V i kanë kërkuar shtetasit B.V shumën 410,000 lekë për t'i përdorur për mobilimin e shtëpisë. Në datën 20.7.2016, shtetasi M.V deklaroi se nga kursimet e shtetasve Y dhe XH.V ka kaluar për shlyerjen e detyrimit total në llogarinë e shtetasit B.V shumën 9,002.67 euro (shumë e konvertuar 1,229,764 lekë). Në praninë e noterit shtetasit Y dhe XH.V i kanë dhënë shumën 160,236 lekë shtetasit B.V dhe me likuidimin e kësaj shume është shlyer tërësisht detyrimi i tyre.

39.2 Rezulton se në datën 24.2.2015, përpara ILDKPKI⁸³-së, subjekti ka deklaruar se bashkëshorti i saj ka qenë emigrant në Itali që në vitin 1992 dhe ka krijuar të ardhura. Një pjesë të të ardhurave ia dërgonte babait në Vlorë, i cili i mbledhte apo i menaxhonte duke i sistemuar në banka.

39.3 Në bazë të deklarimeve të subjektit dhe akteve të administruara rezulton e provuar marrëdhënia e mëposhtme e huadhënies midis bashkëshortit të subjektit, babait dhe vëllait të tij.

39.4 Në DIPP/2009, në seksionin e të dhënave të personave fizikë dhe juridikë, përfshirë edhe personat e besuar, bashkëshorti deklaroi: “M.SH.V, i ati. Lloji i interesit: huadhënie, lagjja “***”, Vlorë”.

39.5 Në analizë të deklarimeve të bëra në DIPP/2009 dhe të dokumentacionit për llogaritë bankare, vlerat të cilat janë depozituar nga prindërit e tij M.V dhe N.V pranë BKT-së deri në datën 31.12.2008 rezultojnë në total 3,690,918 lekë.

39.6 Nga hetimi rezultoi e provuar se me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 26.5.2016, me objekt shitjen e pasurisë apartament nr. ***, me sip. 73 m², z. k. ***, Vlorë, është shitur nga shtetasit Y.V dhe XH.V një pasuri në shumën 2,300,000 lekë. Me prokurën e posaçme datë 11.5.2016, të nënshkruar nga shtetasit Y.V dhe XH.V, përcaktohet se shuma 2,300,000 lekë, e përfituar nga shitja e apartamentit, do të kalojë në llogarinë e shtetasit B.V në BKT.

⁸³ Shihni kthim përgjigjen nr. *** prot., datë 12.3.2021, nga ILDKPKI-ja.

39.7 Komisioni hetoi mbi këtë pasuri ku rezultuan përputhje të deklarimeve të subjektit me provat e administruara nga ku rezulton se kemi të bëjmë me një pronë të ardhur si pasojë e privatizimit të këtij apartamenti nga shtetasit Y dhe XH.V, me kontratën e shitblerjes datë 16.11.1994, në vlerën 10,302 lekë.

39.8 Në lidhje me kthimin e huas rezultoi⁸⁴ në llogarinë e bashkëshortit në datën 23.6.2016, transferohet shuma 2,300,000 lekë, me përshkrimin “S.H kalon për B.V pagesë për blerje apartamenti nga D.L për shitësit Y dhe XH.V sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.5.2016 dhe prokurës bashkëngjitur”. Ndërsa në datën 11.7.2016 bashkëshorti tërheq vlerën 410,000 lekë. Vlera e mbetur e llogarisë prej 1,887,300 lekësh është mbajtur si depozitë kursimi deri në datën 23.1.2017 dhe më pas bashkëshorti e ka transferuar shumën 1,887,300 lekë nga llogaria e tij në BKT pranë llogarisë tjetër të tij në Credins Bank.

39.9 Nga hetimi rezulton se nga babai i bashkëshortit, në llogarinë e tij, është transferuar vlera 9,002.67 euro, konfirmuar nga Credins Bank⁸⁵, e cila është kryer në datën 20.7.2016. Gjithashtu, në llogarinë e bashkëshortit është derdhur *cash* vlera 9,000 euro në datën 28.1.2016 nga shtetasi Y.V, me përshkrimin “Kthim borxhi”.

39.10 Në analizë të mundësisë së vëllait të bashkëshortit për të shlyer këtë detyrim rezulton e provuar se për periudhën 1999 – 2020, si rezultat i punës së kryer në shtetin italian shtetasi Y.V ka përfituar në total deri në vitin 2015 shumën 340,357 euro. Komisioni hartoi analizën financiare si më poshtë paraqitur për të hetuar mundësinë e kthimit nga shtetasi Y.V dhe nga analiza financiare e kryer rezulton se mundësia për kursim e tij për periudhën 2008 – 2015 ka qenë 122,000 euro, e cila është e mjaftueshme për të kthyer huan ndaj shtetasit B.V⁸⁶.

39.11 Gjithashtu, nga hetimi i llogarive bankare të shtetasve Y dhe XH.V rezulton se ata kanë hapur llogari dhe depozita kursimi dyemërore me titullar shtetasit M.V dhe Y.V prej vitit 2004⁸⁷. Në llogarinë e tyre pranë BKT-së⁸⁸ rezulton se janë kryer edhe veprime nga shtetasi M.V, duke tërhequr ose depozituar në këto llogari. Gjithashtu vihet re se depozita e kursimit në monedhën euro me vlerë 7,036.02 e shtetasit Y.V është tërhequr *cash* në datën 30.6.2015, pak muaj para depozitimit në llogarinë e shtetasit M.V.

Vlerësimi i Komisionit

39.12 Në përfundim të hetimit, Komisioni çmon se bazuar në prova dhe fakte subjekti ka kryer një deklaram të saktë lidhur me këtë marrëdhënie huaje.

ANALIZA FINANCIARE TETOR 2009 – 2016

40. Metodologjia e kryerjes së analizës financiare

40.1 Për efekt të pasqyrimit të metodologjisë së ndjekur, Komisioni në këtë analizë financiare është bazuar në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të

⁸⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 17.3.2021, nga BKT-ja.

⁸⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 9.4.2021, nga Credins Bank.

⁸⁶ [Statistics | Eurostat \(europa.eu\)](https://statistics.eurostat.eu)

⁸⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 21.7.2023, nga Raiffeisen Bank.

⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2023, nga BKT-ja.

ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.

40.2 Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat në vlerë neto, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

40.3 Shpenzimet e jetesës u bazuan në ato të përcaktuara në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së, drejtuar Komisionit. Në llogaritjen e shpenzimeve jetike, në analizën financiare është përfshirë numri i anëtarëve të familjes për të cilët është bërë trajtimi i shpenzimeve jetike në bazë të deklarimit të subjektit në pyetësonin standard, por duke u mbështetur edhe në gjendjen familjare sipas certifikatave të gjendjes civile.

40.4 Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, si dhe në deklaratimet e subjektit⁸⁹. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit, si dhe deklaratimet e subjektit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit, kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune, të cilat janë provuar me dokumentacion. Gjithashtu janë konsideruar vetëm shpenzimet minimale prej 5 euro si shpenzime ditore dhe nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar tek të afërmit dhe e ka provuar me dokumentacion deklarimin e tij. Në rastet e tjera, kur deklaratimet e subjektit kanë qenë të pambështetura në dokumentacion provues, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit janë konsideruar mbi bazën e vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit. Për udhëtimet ditore, vajtje-ardhje brenda ditës, janë konsideruar vetëm shpenzimet e udhëtimit dhe 5 euro si shpenzime ditore.

40.5 Shpenzimet për blerje automjesh⁹⁰ u bazuan në deklaratimet vjetore të subjektit, pyetësonët, si dhe në dokumentacionin përkatës. Gjithashtu janë përfshirë në analizën financiare shpenzime qiraje sipas deklaratimeve të subjektit dhe bashkëshortit në deklaratat periodike dhe në deklaratën *Vetting*.

40.6 Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë si dhe gjendja e likuiditeteve⁹¹ në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

40.7 Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasua përputhshmëria e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe në aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

40.8 Në konkludim të sa më sipër, analiza financiare për periudhën shkurt 2009 – 2016 rezultoi me vlerë negative -652,147 lekë, ndërsa analiza përpara fillimit të deklarimit të vitit 2009 rezultoi me pamundësi financiare në vlerën -13,534,814 lekë.

⁸⁹ Përgjigjet e pyetësonit standard.

⁹⁰ Kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.7.2023, nga DPSHTRR-ja.

⁹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.3.2021, nga BKT-ja; shkresë nr. *** prot., datë 12.4.2021, nga Intesa Sanpaolo Bank; shkresë nr. *** prot., datë 17.3.2021, nga Raiffeisen Bank; shkresë nr. *** prot., datë 12.3.2021, nga ABI Bank; shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2021, nga Tirana Bank; shkresë nr. *** prot., datë 9.4.2021, nga Credins Bank; shkresë nr. *** prot., datë 19.3.2021, nga ProCredit Bank; shkresë nr. *** prot., datë 19.3.2021, nga Alpha Bank; shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021, nga OTP Bank.

40.9 Subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

40.10 Subjekti parashit argumente dhe prova, të cilat janë analizuar në këtë vendim në analizën e burimit të krijimit të pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

40.11 Komisioni çmon se në përputhje me arsyetimin e bërë në këtë vendim, duke realizuar një analizë financiare, ku të ardhurat e bashkëshortit nga shitja e shoqërisë “****”, pavarësisht se nuk janë konsideruar nga trupi gjykues si të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duke qenë se ato nuk mund të jenë penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, analiza financiare e subjektit rezulton me një bilanc⁹² për periudhën shkurt 2009 – 2016, me vlerë negative -152,147 lekë. Ndërsa, analiza përpara fillimit të deklarimit të vitit 2009 rezulton me pamundësi financiare në vlerën -11,902,960 lekë.

Konkluzion përfundimtar për kriterin e pasurisë

41. Komisioni vlerëson në lidhje me pasurinë e subjektit të rivlerësimit në një optikë të përgjithshme, sipas standardit kushtetues të parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës të “shpjegimit bindshëm” të pasurisë, duke zbatuar parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit në kuptim të parashikimit të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili obligon organet e rivlerësimit që në mënyrë diskrecionale, por të arsyetuar e të shpjeguar, të shqyrtojnë procesin e rivlerësimit të një subjekti, duke konsideruar zbatimin e këtyre parimeve të së drejtës administrative të aplikueshme.

42. Bazuar edhe në parimin e objektivitetit, i cili parashikohet nga neni 14 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit “*Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe u japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative*”, Komisioni vlerësoi se të gjitha rrethanat, në mënyrë thelbësore lidhen me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit në Itali dhe shitjen e një aktiviteti në vitin 2004.

43. Komisioni vlerësoi rrethanat e analizuara në arsyetimin e këtij vendimi në harmoni dhe në raport me të gjitha çështjet e tjera, të cilat u trajtuan në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit në dritën e parimit të proporcionalitetit, parashikuar në nenin 12 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “*Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. 2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës; b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë*”.

44. Në mungesë të ndonjë të dhëne që të bën të dyshosh se subjekti i vlerësimit me deklarimin e të ardhurave të tilla ka synuar të mashtrtojë organet e rivlerësimit ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme, trupi gjykues çmon se pasuria e deklaruar ka si burim të ardhurat e bashkëshortit, të krijuara kohë më parë se ata të fillonin bashkëjetesën ligjore. Këto të ardhura rezultojnë nga burime të ligjshme, të dokumentuara me akte juridike dhe transaksione bankare, ku i vetmi element që nuk përmbush kushtet e nenit D, pika 3, është pagesa e tatimeve gjatë

⁹² Për më shumë referojuni analizës financiare të rezultateve të hetimit.

procesit të rivlerësimit. Kjo situatë faktike nuk është e drejtë të konsiderohet si një mangësi apo defekt, i cili të prodhojë pasoja për subjektin e rivlerësimit, vendosjen e masës së shkarkimit të tij nga detyra. Kjo mangësi, duke qenë se është e vetmja e konstatuar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, e vendosur në kontekstin e mësipërm, nuk vlerësohet se mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

45. Ky qëndrim i trupit gjykues është në përputhje me vendimet nr. 6, datë 17.3.2022 dhe nr. 6, datë 17.3.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

46. Në përfundim, për sa më sipër, Komisioni çmon se mungesa e burimeve të ligjshme që rezulton nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë të ardhurat e bashkëshortit nga shitja në vitin 2004 të shoqërisë “***”, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

47. Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë, si vijon:

- i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të saj.
- iii. Mungesa e burimit të ligjshëm për krijimin e një pasurie para rikthimit të subjektit në detyrë, si e vetmja gjetje në kuadër të vlerësimit të pasurisë së subjektit, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia.
- iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

ANALIZA FINANCIARE 2009 – 2016

<i>Përshkrimi</i>	para fillimit të deklarimit deri janar 2009	06.02.2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	23,646,020	(79,039)	563,002	1,168,814	2,404,542	97,470	2,551,606	(94,999)	(6,669,021)
Tokë bujqësore me sip. 1,300 m2, në N*, V*. Burimi i krijimit: Nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, pjesa takuese 20%.									
Bashkëshorti: Tokë bujqësore, sip. 1.000 m2, 3.200 m2, 2.500 m2 në R*, V* blerë më 16-17.03.2010. Vlera 60,000 lekë, 320,000 lekë dhe 150,000 lekë.			530,000						
Bashkëshorti: Tokë bujqësore, sip. 4,560 m2, 4.300 m2 në R*, V* blerë më 16.04.2012. Vlera 273,600 lekë dhe 258,000 lekë.					531,600				
Bashkëshorti deklaror: Tokë bujqësore, sip. 31,525 m2, në M*, T*ë blerë me kontrata nr. */*, dt. 17.06.2011, nr. */*, dt. 22.06.2011 dhe nr. */*, dt. 22.11.2011. Vlera 301 lekë për m2. Burimi i krijimit: Me pjesën e mbetur të të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit në dt. 08.07.2010 dhe të ardhura të kursyera.				451,500					
Apartament banimi, sip. 111.6 m2, (120.7 m2), lagje 2* N*, V*, blerë më 3.5.2006. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti si shef guzhine i bashkëshortit dhe aktiviteti si avokate i deklarueses. Vlera 60,000 euro, pjesa takuese 50%.	7,376,312								
Bashkëshorti deklaror: Apartament banimi sip. 65 m2, lagje O* H*, V*, blerë në datë 15.11.1994. Burimi i krijimit: Kontratë privatizimi. Vlera 10,801 lekë, pjesa takuese 33.3%.									
Autoveturë Daimler Chrysler, me targa V*, blerë më 22.1.2008 dhe shitur më 8.7.2010. Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti si avokate e bashkëshortes dhe aktiviteti si shef guzhine. Vlera 500,000 Lekë, pjesa takuese 50%	500,000		(500,000)						
Autoveturë Daimler Chrysler, blerë më datë 24.6.2009. Vlera 9.100 euro, detyrim doganor 479,000 lekë, pjesa takuese 50%.		1,727,247							
Autoveturë Daimler Chrysler, blerë me kontratën nr. 2*/1*, dt. 01.04.2011. Vlera 5,000 euro. Burimi i krijimit: Me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit në dt. 08.07.2010.				691,500					
Dhënë hua në dt. 12.07.2008 personi fizik (E* G*). Burimi i krijimit: Të ardhura nga aktiviteti si avokate dhe aktiviteti si shef guzhine i bashkëshortit	2,094,103	(2,094,103)							
Dhënë hua shtetasit M* V*	3,000,000								(3,105,322)
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë	10,675,605	287,817	533,002	25,814	1,872,942	97,470	2,551,606	-94,999	-3,563,699
Total likuiditete	10,675,605	10,963,422	11,496,424	11,522,238	13,395,180	13,492,650	16,044,256	15,949,256	12,385,557
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0
PASURI NETO	23,646,020	(79,039)	563,002	1,168,814	2,404,542	97,470	2,551,606	(94,999)	(6,669,021)
TË ARDHURA të dokumentuara	13,840,728	4,734,372	1,947,185	1,513,211	3,410,761	2,354,346	3,522,829	1,896,796	1,569,372
Të ardhura të subjektit nga paga per periudhen 1995-2002	0								
Të ardhura të subjektit nga paga e subjektit të rivlerësimit		697,136	866,367	927,996	917,719	954,015	1,261,153	1,299,048	1,330,137
Të ardhura të subjektit nga aktiviteti si avokate e subjektit të rivlerësimit	4,876,680								
Të ardhura të ekzekutimi i vendimeve të gjykatave për subjektin e rivlerësimit				461,183	2,265,545	1,087,480	1,702,027		
Të ardhura të bashkëshortit nga shitja e aktivitetit dhe nga paga në emigracion 1992-2005 dhe nga kambliat	4,434,170	3,041,355							
Të ardhurat të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si shef guzhine 2005-2011	4,493,334	916,667	1,000,000						
Të ardhurat të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si avokat pranë Dhomës së Avokatisë V* 2011-2014				51,623	150,504	156,232	26,636		
Të ardhurat të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si avokat shteti pranë Avokaturës së Shtetit V*, 25.02.2014 - 22.05.2014.							95,348		
Të ardhurat të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit si shef guzhine 02.07.2014-22.10.2015							263,225	597,748	
Të ardhura të bashkëshortit nga pjesëmarrja në emisionin televiziv vlera 1,554 euro									
Të ardhura nga interesat e depozitave të kursimit pranë C* dhe R* bank	36,545	79,214	80,818	72,409	76,993	156,619	174,440	-	239,235
SHPENZIME	2,097,669	566,883	455,387	496,544	896,595	877,703	652,745	681,129	7,883,520
Shpenzime për mobilimin	800,000								7,034,040
Shuma e gjendjes cash ne banese e vjedhur ne dt. 04.08.2016									
Shpenzime udhëtimi	335,839	316,413	182,147	223,304	617,499	595,655	212,749	120,439	144,204
Shpenzime jetike	961,829	250,470	273,240	273,240	279,096	282,048	439,996	560,690	705,276
Analiza dokumentuar	(11,902,960)	4,246,528	928,795	(152,147)	109,624	1,379,174	318,478	1,310,666	354,873

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

48. Bazuar në konkluzionet më lart, për të gjitha pasuritë e deklaruar të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni ka një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, pasi nga një vlerësim proporcional dhe objektiv nuk u vërejtën shkaqe të tilla që të përmbushnin qëllimin e aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve. Në këtë vlerësim, trupi gjykues u bazua në bindjen e brendshme, pas vlerësimit objektiv të të gjitha pasurive dhe mjeteve monetare të krijuara nga subjektit i rivlerësimit në funksionin e gjyqtarës, ekzistencën e mjeteve financiare në dispozicion, të cilat përmbushin plotësisht kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe rrethanat specifike të rezultuara nga hetimi administrativ për subjektin Mirela Mishgjoni.

49. Komisioni vlerëson të ndalet në lidhje me krijimin e të ardhurave të bashkëshortit të subjektit përpara njohjes dhe martesës me subjektin, të cilat kanë shërbyer për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 70,000 euro dhe blerjen e të vetmit apartament në vitin 2005, kohë në të cilën subjekti nuk ka qenë në detyrë dhe ushtronte profesionin e avokates. Komisioni çmon se periudha në të cilën bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka krijuar këto të ardhura, ka qenë përtej kohës kur personi i lidhur dhe subjekti i rivlerësimit ishin në kushtet e bashkësisë ligjore dhe kur subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur vepronin financiarisht në autonomi të plotë. Trupi gjykues konstaton se pavarësisht problematikave që mund të rezultojnë si pasojë e mospagimit në kohë të detyrimeve tatimore për këto të ardhura, pasi përfitimi i tyre provohet me dokumentacion të rregullt noterial, por edhe bankar, nga hetimi administrativ në Komision nuk u ngritën dyshime lidhur me krijimin e këtyre të ardhurave nga aktivitete të kundërligjshme të personit të lidhur. Si rrjedhojë, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është në kushtet e dijenisë dhe të pranimit të faktit që ka pranuar të përdorë një banesë për të cilën ka ditur se është krijuar nga të ardhura me burime të kundërligjshme, situatë kjo që do ta bënte të cënueshëm besimin e publikut për subjektin e rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues, në vlerësim të situatës faktike, çmon se problematikat e konstatuara lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit, të krijuara para martesës me subjektin e rivlerësimit, nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në këtë proces për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit. Ndërsa problematikat që lidhen me pasuritë e vëna prej tij apo defektet në deklarimin e saj, të cilat përsëri konsistojnë në një situatë të mbartur nga pasuritë e personit të lidhur, të krijuara para martesës, gjithashtu nuk janë të mjaftueshme e proporcionale për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe se ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar, për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit.

50. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

51. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Për sa më sipër, trupi gjyqës vlerëson se subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

52. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

53. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar në Komision raportin⁹³ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

54. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

55. Me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2023, AKSIK-ja informon se nuk ka të dhëna që mund të shërbejnë si bazë për rishikimin e raportit fillestar në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

56. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

57. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklaratime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

⁹³ Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** , datë 22.9.2023, të KDZH-së.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

58. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

59. Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

60. Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

61. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

62. Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti dhe nga analizimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-së

63. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtarja Mirela Mishgjoni ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 10.7.1995. Pas studimeve, në datën 8.2.1996, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Më pas, me vendimin nr. ***, datë 15.7.2002, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është shkarkuar nga detyra e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Znj. Mirela Mishgjoni ka kërkuar në Këshillin e Lartë të Drejtësisë rishqyrtimin e çështjes së shkarkimit nga detyra, në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. ***, datë 12.11.2004, kërkesë kjo që është futur në rend dite në mbledhjen e KLD-së dhe me vendimin nr. ***, datë 24.10.2008, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i është dhënë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra. Më pas, me vendimin nr. 6, datë 6.2.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është shfuqizuar vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të gjyqtares Mirela Mishgjoni, duke e rikthyer në pozicionin e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku vazhdon edhe aktualisht⁹⁴.

⁹⁴ Shihni informacionin e dërguar nga KLGJ-ja me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 26.3.2021) dhe informacionin në raportin profesional të përgatitur nga KLGJ-ja.

64. Nga të dhënat e regjistrit të ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtaren Mirela Mishgjoni janë paraqitur 4 ankesa (2 në vitin 2014, 1 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Mirela Mishgjoni përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

65. Referuar informacionit të përcjellë në Komision nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë⁹⁵, ndaj subjektit të rivlerësimit janë administruar 13 ankesa.

66. Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 19 denoncime të paraqitura pranë Komisionit, i cili i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me denoncimet si vijon:

66.1 Denoncim nr. * prot., datë 20.2.2018, i shtetases V.XH**

Denoncuesja pretendon se është dënuar pa të drejtë djali i saj I.XH, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike”, të kryer në bashkëpunim. Pretendon se dënimi është dhënë i pambështetur në prova.

Komisioni administroi⁹⁶ vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁹⁷ dhe Gjykatës së Apelit Vlorë⁹⁸ në lidhje me çështjen në fjalë, nga të cilat rezultoi se:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur deklarinimin fajtor të të dy të pandehurve për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 283/2 të Kodit Penal dënimin e secilit prej tyre me 8 vjet burgim.

- Gjykata e Apelit Vlorë ka çmuar se: *“Gjykata e Shkallës së Parë duhet të mbante parasysh gjatë procesit të çmuarjes e vlerësimit të provave urdhërimet e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale në fuqi në kohën e vendimmarrjes... Megjithëse në arsyetimin e vendimit citohet përmbajtja e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, nuk rezulton të jetë bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë dispozitë. Ndryshe nga sa ka arsyetuar Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit vlerëson se nuk provohet në këtë rast tej çdo dyshimi të arsyeshëm kryerja e veprës penale në bashkëpunim”. Për shkak të këtij arsyetimi, Gjykata e Apelit ka vlerësuar ndryshe nga Gjykata e Shkallës së Parë se në lidhje me të pandehurin I.XH nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ai ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, prandaj në zbatim të nenit 388/d të Kodit të Procedurës Penale⁹⁹ ai duhet të deklarohet i pafajshëm për kryerjen e kësaj vepre. Ndërsa në lidhje me të pandehurin tjetër E.L, në zbatim të nenit 375¹⁰⁰ të Kodit të Procedurës Penale, faktit duhet t’i jepet një kualifikim tjetër juridik që lehtëson pozitën e këtij të pandehuri nga neni 283/2¹⁰¹ në nenin 283/1 të Kodit Penal...”.*

Rezulton se ndryshimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nga Gjykata e Apelit Vlorë ka ardhur jo për shkak të vlerësimit të ndryshëm të provave nga ana e kësaj të fundit, por për shkak

⁹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 13.7.2023).

⁹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 11.7.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 17.7.2023).

⁹⁷ Vendim nr. ***, datë 27.7.2017.

⁹⁸ Vendim nr. ***, datë 7.3.2018.

⁹⁹ “Gjykata merr vendim pafajësie kur: ... d) nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën që akuzohet”.

¹⁰⁰ Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale.

¹⁰¹ Kryerja e veprës në bashkëpunim.

se sipas Gjykatës së Apelit çmuarja e provave nga Gjykata e Shkallës së Parë nuk është bërë në përputhje me parimet procedurale të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale, si dhe në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe atë që çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.

Subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit shpjegoi¹⁰²: *“Rezulton se kam qenë në përbërje të trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen penale kundër të pandehurve E.L dhe I.XH. Me vendimin nr. ***, datë 27.7.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur të deklarojë fajtorë vetëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 238/2 të pandehurit E.L dhe I.XH. Gjykata e Apelit Vlorë ka bërë një interpretim të ndryshëm të provave të marra në gjykim në shkallë të parë dhe ka konkluduar në deklarimin e pafajshëm të të pandehurit I.XH. Në rastin konkret, nga ana e Gjykatës së Apelit nuk janë konstatuar shkelje procedurale në gjykimin e çështjes, në cenimin e të drejtave të të pandehurve apo shkelje procedurale në mënyrën e marrjes së provave, por ka interpretuar në mënyrë të ndryshme provat. Ajo që identifikohet në këtë vendim është ekzistenca e një vlerësimi të ndryshëm të provave. Për sa më sipër, në konsideratë të faktit se vlerësimi i aftësive profesionale kryhet mbi aspektin etik dhe procedural për të evidentuar shkelje të mundshme të të drejtave të palëve, pa iu nënshtruar analizës faktiko-ligjore, ku vlerësimet e provave dhe vendimmarrjet lidhen me themelin e çështjes, çmohet se nuk ekzistojnë të dhëna që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Komisioni për kryesuesin dhe anëtarin tjetër të trupës gjyqëse (vendim nr. 590/2022 dhe nr. 419/2021)”*.

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe duke marrë në konsideratë vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, Komisioni vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me zgjidhjen në themel të çështjes, për rrjedhojë nuk mund të vijojë me vlerësimin e saj në aspektin e aftësive profesionale, pasi nuk rezultojnë parregullsi procedurale në shqyrtimin e çështjes gjyqësore.

66.2 Denoncim nr. * prot., datë 5.4.2018, i shtetasit A.H**

Denoncuesi pretendon se është gjykuar dhe dënuar nga subjekti i rivlerësimit për falsifikim dokumentesh, në shkelje të të drejtave për proces të rregullt ligjor. Ai pretendon se në një seancë mbrojtësi i caktuar prej tij, të cilit i kishte dhënë të drejtë ta përfaqësonte edhe në mungesë, nuk është paraqitur dhe gjykata i ka caktuar atij mbrojtës kryesisht. Pretendon se vendimi për zëvendësimin e mbrojtësit nuk i është komunikuar atij dhe gjykata ka vazhduar gjykimin në mungesë dhe se këtë fakt, pra zëvendësimin e mbrojtësit me mbrojtës të caktuar kryesisht, e ka mësuar pas 6 muajsh. Sipas pretendimit të denoncuesit, prokurori i ka kërkuar gjykatës mospranimin e prokurës, me argumentin se prokura është hartuar tek një noter që ka zyrën pranë gjykatës dhe prokura nuk është pranuar për shkak të një lapsusi të noterit. Denoncuesi pretendon se gjyqtarja, në vend që të ndërpriste gjykimin dhe t'i jepte kohë avokatit të rregullonte prokurën, vazhdoi gjykimin dhe seancën e radhës e caktoi ditën e nesërme; në atë seancë mbylli shqyrtimin gjyqësor, duke mos i dhënë mundësi avokatit që ta mbronte.

¹⁰² Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

Komisioni administroi nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë¹⁰³ procesverbalet e seancave gjyqësore dhe regjistrimet audio të seancave, si dhe vendimin e kësaj gjykate dhe të Gjykatës së Apelit Vlorë, nga të cilat rezultoi se:

Denoncuesi ka qenë i pandehur për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Çështja është gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë nga subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni, e cila në përfundim të gjykimit ka vendosur¹⁰⁴, ndër të tjera, deklarimin fajtor të të pandehurit A.H për kryerjen e kësaj veprë penale dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 20.9.2017, e cila nuk ka konstatuar shkelje procedurale të kryera nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga procesverbalet e seancave gjyqësore rezulton se në seancën e parë gjyqësore, i pandehuri (denoncuesi) ka zgjedhur avokatin e tij (A.K) për ta përfaqësuar atë edhe në mungesë. Avokati ka qenë i pranishëm në këtë seancë, ku ka shprehur dakordësinë me përfaqësimin. Është caktuar seanca e radhës, duke iu komunikuar data të pranishmëve (ku ishte si i pandehuri, ashtu edhe mbrojtësi i caktuar prej tij). Në seancën e radhës nuk është paraqitur as i pandehuri A.H, as mbrojtësi i caktuar prej tij, pavarësisht nga fakti se kishin dijeni, ndaj gjykata në bazë të nenit 351 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur të deklarojë mungesën e të pandehurit dhe në bazë të neneve 49 dhe 351 të këtij Kodi, ka vendosur t’i caktojë atij një mbrojtës kryesisht.

Janë shtyrë disa herë seancat gjyqësore për shkaqe të konsideruara nga gjykata si të ligjshme (mosmarrje njoftimi nga i pandehuri tjetër, ndryshime të herëpashershme të mbrojtësve të të pandehurit tjetër) dhe në të gjitha këto seanca i pandehuri A.H (denoncuesi) është përfaqësuar nga mbrojtësi i caktuar kryesisht në seancën e dytë.

Në seancën kur duhet të paraqisnin konkluzionet përfundimtare (datë 3.12.2015), krahas mbrojtësit të caktuar kryesisht nga gjykata, është paraqitur në seancë edhe mbrojtësi i caktuar nga i pandehuri, av. D.M, për të cilin gjykata ka vendosur ta konsiderojë të parregullt prokurën, pasi nuk mund të identifikojë vullnetin e të pandehurit. Avokatja e caktuar kryesisht i ka parashtruar gjykatës se e ka marrë i pandehuri në telefon dhe i ka thënë: *“Nuk do më përfaqësosh ti se kam zgjedhur avokat tjetër”*. Gjykata i ka konsideruar të pajustificuara kërkimet e mbrojtësve, megjithatë për të garantuar të drejtat e të pandehurve ka vendosur të shtyjë seancën gjyqësore¹⁰⁵.

Në seancën e radhës (të parafundit) dhe në seancën e fundit, atë të shpalljes së vendimit, është paraqitur mbrojtësja e caktuar kryesisht që në fillim të procesit, nuk rezulton të jetë paraqitur mbrojtësi i caktuar nga i pandehuri, megjithëse kishte mundësi të korrigjonte të metat e prokurës dhe të paraqitej në seancë.

Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me arsyet e vijimit të procesit gjyqësor me një avokat të caktuar kryesisht dhe në mungesë të vullnetit të të pandehurit.

¹⁰³ Shkresë nr. *** prot., datë 11.7.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 17.7.2023).

¹⁰⁴ Vendim nr. ***, datë 7.12.2015.

¹⁰⁵ Shihni procesverbalin e seancës gjyqësore datë 3.12.2015.

Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, shpjegoi se¹⁰⁶: “Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. ***, datë 12.10.2023, ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga të pandehurit A.H dhe M.Q, duke arsyetuar: lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura në rekurs, Kolegji çmon se nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen objekt rekursi dhe rezulton se nga gjykatat më të ulëta nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit.

I pandehuri A.H është gjykuar pa masë sigurimi dhe është paraqitur personalisht në seancën gjyqësore të datës 29.4.2015. Në këtë seancë ka deklaruar avokatin e tij, duke deklaruar që gjykimi të vijojë në mungesë të tij. Në seancën e radhës nuk është paraqitur i pandehuri dhe as përfaqësuesi i tij, duke mos e justifikuar mosparaqitjen në këto rrethana në bazë të nenit 351/1 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata vendosi të deklarojë mungesën e të pandehurit, duke i caktuar një avokat kryesisht dhe e ka shtyrë seancën duke urdhëruar njoftimin e avokatit. Gjykimi ka vijuar në mungesë të të pandehurit. Në seancën gjyqësore të datës 3.12.2015 është paraqitur av. D.M... nga përmbajtja e prokurës ishte e pamundur të identifikohet vullneti i të pandehurit. Gjykata e ka shtyrë gjykimin me qëllim plotësimin e të metave të përfaqësimit, por në datën e caktuar nuk u paraqit as i pandehuri, as avokati... në këto rrethana, gjykata ka vijuar dhe përfunduar gjykimin në mungesë të tij, në prani të avokatit të caktuar kryesisht...”

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe duke marrë në konsideratë vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, Komisioni vlerëson se nga ana e kësaj gjykate janë vlerësuar pretendimet e të pandehurve, duke mos u konsideruar se kemi të bëjmë me shkelje procedurale, për rrjedhojë nuk mund të vijojë me vlerësimin në aspektin e aftësive profesionale, pasi nuk rezultojnë parregullsi procedurale në shqyrtimin e çështjes gjyqësore.

66.3 Denoncimet nr. * prot., datë 23.2.2023, nr. *** prot., datë 7.6.2023, nr. *** prot., datë 22.8.2023, nr. ***, datë 23.10.2023 dhe nr. *** prot., datë 4.4.2023, të shtetas V.Ç**

Denoncuesja ka qenë palë e paditur në një proces gjyqësor civil të shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit Mirela Mishgjoni, në përfundim të të cilit, me vendimin nr. ***, datë 3.3.2023, subjekti ka vendosur pranimin e padisë.

Komisioni administroi¹⁰⁷ këtë vendim të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (nga subjekti i rivlerësimit), nga i cili rezultoi se:

Denoncuesja V.Ç ka qenë palë e paditur së bashku me shtetasit P.Ç (bashkëshorti) dhe N.Ç (vajza) në procesin gjyqësor me paditës A.A dhe objekt “Deklarimi i pavlefshëm i kontratës nr. ***, datë 17.7.2015, si veprim i kryer për të pakësuar pasurinë e debitorit P.Ç”, padi e gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

Para kësaj padie ata kanë qenë prej vitesh në konflikt civil dhe palë në një proces gjyqësor civil, në përfundim të të cilit gjykata me vendimin e datës 6.10.2014 e ka ngarkuar z. P.Ç me detyrimin për t’i dorëzuar shtetasit A.A disa pasuri dhe për t’i paguar atij një vlerë monetare të përcaktuar,

¹⁰⁶ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit, të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

¹⁰⁷ Me shkresën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nr. *** prot., datë 11.7.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 17.7.2023).

si dhe ka vendosur sigurimin e padisë, duke bllokuar tjetërsimin ose dhënien me qira te të tretë të sendeve të paluajtshme objekt rivendikimi dhe bllokimin e llogarive bankare¹⁰⁸. Ky vendim është lënë në fuqi për këtë pjesë nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 6.10.2015.

Pas vendimit të shkallës së parë, debitori P.Ç me kontratën e dhurimit nr. ***, datë 17.7.2015, i ka dhuruar vajzës së tij N.Ç (e bashkëpaditur në procesin në fjalë) një pasuri të ndodhur në H, Vlorë, me sip. 529 m² truall dhe 315.38 m² ndërtesë. Kjo kontratë është objekt i konfliktit gjyqësor të gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, pasi pala paditëse A.A si debitor ka kërkuar nga gjykata deklarimin e pavlefshmërisë së këtij veprimi juridik, duke pretenduar se ky është një veprim juridik i simuluar dhe se qëllimi i vetëm i tij ka qenë pakësimi i pasurisë së debitorit P.Ç, për të shmangur përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorëve.

Në denoncimet e paraqitura në Komision, denoncuesja ka ngritur pretendime për zgjidhje të gabuar të çështjes nga ana e gjyqtarës, si dhe për një sërë shkeljesh të kryera prej saj, pasi provat e paraqitura në gjykatë nga paditësit janë marrë prej tyre në rrugë joligjore dhe janë administruar nga gjykata në kundërshtim me ligjin procedural civil. Konkretisht, në mënyrë të përmbledhur denoncuesja ka pretenduar se:

- Gjyqtarja hapi seancën gjyqësore pa bërë seancë përgatitore.
- Gjyqtarja ka pranuar një padi pa verifikuar provat shkresore të paraqitura nga paditësit, se provat e paraqitura nga paditësit për ngritjen e padisë janë të vjedhura, të falsifikuara dhe fotokopje. Janë vjedhur certifikatat origjinale të lindjes së të paditurve nga organet kompetente, të cilat kanë për detyrë t'i ruajnë ato, pasi paditësit janë pajisur me certifikatat e lindjes së të paditurve, duke i marrë ato në shkelje të procedurave, pasi nuk ka asnjë autorizim për tërheqje të këtyre akteve të të dhënave personale. Në lidhje me këtë fakt kanë paraqitur denoncim pranë Ministrisë së Brendshme, e cila i ka informuar se ka nisur një hetim administrativ për çka ka ndodhur, me qëllim identifikimin e personave që e kanë kryer këtë veprim, si dhe gjurmimin e certifikatave origjinale, ku janë çuar ato dhe për çfarë tjetër janë përdorur, pasi u konstatua se origjinalet nuk ishin dorëzuar në gjykatë. Denoncuesja ka vënë në dijeni gjyqtaren dy herë me

¹⁰⁸ Z. P.Ç si administrator i shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. dhe z. A.A kanë qenë palë kontraktuale në disa kontrata të lidhura midis tyre sa i përket ndërtimit të një objekti, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit në favor të shoqërisë “****”. Në bazë të aktmarrëveshjes së lidhur midis këtyre palëve në datën 1.10.2003, paditësi A.A ka marrë përsipër 90% të financimit të punimeve të ndërtimit, ndërsa i padituri ka marrë përsipër 10% të investimit. Meqenëse deri në vitin 2006 shoqëria “****” sh.p.k. nuk kishte realizuar detyrimet e marra përsipër kundrejt paditësit A.A me aktmarrëveshjen e mësipërme, në datën 23.2.2006, palët kanë lidhur një tjetër aktmarrëveshje, në bazë të së cilës paditësi A.A paraqitet në cilësinë e investitorit ekskluziv të ndërtimit, ndërsa i padituri P.Ç, përfaqësues i shoqërisë “****” sh.p.k., paraqitet vetëm në cilësinë e ndërtuesit. Me përfundimin e punimeve të ndërtimit, shoqëria “****” nuk ka përmbushur detyrimet e marra përsipër me kontratat e sipërpërmendura ndaj investitorit kryesor A.A, për këtë arsye ky i fundit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila në datën 6.10.2014 ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë dhe detyrimin e të paditurit: (i) t'i dorëzojë në natyrë paditësit disa ambiente që posedohen nga i padituri; (ii) t'i paguajë palës paditëse vlerën e ambienteve të tjera të kërkuara nga ky i fundit (të specifikuar në vendim), që në bazë të kontratave të sipërmarrjes posedohen nga të tretë; (iii) t'i paguajë palës paditëse përfitimet në të holla të marra nga dhënia me qira e një ambienti, në shumën 140,070 euro ose 19,609,800 lekë; (iv) sigurimin e padisë, duke bllokuar tjetërsimin ose dhënien me qira te të tretët të sendeve të paluajtshme objekt rivendikimi, si dhe bllokimin e llogarive bankare.

korrespondencë për këtë fakt, si dhe në seancën gjyqësore, por ajo nuk ka marrë asnjë masë për krimet e paditësve.

- Kontrata e dhurimit objekt padie është vjedhur nga paditësit dhe është fotokopje pa elementet përbërëse. *“Gjykata neve na dërgoi një fotokopje pa elementet përbërëse, ndërsa në dosjen origjinale ndodhej po kjo fotokopje, por ishte bërë shënimi “Njësia me origjinalin, noterizuar nga notere A. S”. Si është e mundur që paditësit të jenë pajisur me origjinalin e kontratës sonë të dhurimit dhe ta kenë paraqitur pranë noteres për njësim me origjinalin? Asnjë prej nesh nuk u ka dhënë origjinalin paditësve dhe jemi vënë në dijeni se asnjë organ kompetent nuk ka lëshuar origjinalin”.*
- Kartela e pronësisë e paraqitur si provë është e falsifikuar.
- Gjyqtarja nuk pranoi të ndërpriste gjykimin dhe të merrte masat përkatëse, por vendosi të tërhiqej për vendim.

Rezulton¹⁰⁹ se denoncuesja ka paraqitur ndaj subjektit të rivlerësimit ankesë edhe pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me rastin në fjalë dhe ankesa ndodhet pranë këtij institucioni në fazën e shqyrtimit fillestar.

Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me pretendimet e denoncueses për vlerësimin e provave të pretenduara si të parregullta/të falsifikuara.

Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, shpjegoi¹¹⁰: *“Në lidhje me pretendimet e ngritura mbi korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, mënyrën e interpretimit të ligjit dhe të çmimit të provave nga ana e subjektit, këto janë rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni bazuar në pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, pasi Komisioni analizon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerëson. Në lidhje me pretendimin e denoncueses për pavlefshmërinë e provave pasi ato janë të falsifikuara, këto pretendime janë paraqitur nga denoncuesja në kallëzimet penale, kallëzime për të cilat është vendosur mosfillim i procedimit penal... denoncuesja u referohet kopjeve të akteve provuese të bashkëlidhura në kërkesëpadi, që u janë komunikuar të paditurve gjatë veprimeve paraprake... provat e paraqitura nga paditësi kanë qenë të njësuara me origjinalin nga noteri publik, i cili ka detyrimin ligjor të verifikojë origjinalin e dokumentit. Në gjykim nuk rezultoi asnjë e dhënë që të drejtonte gjykatën drejt dyshimit se provat e dorëzuara ishin të falsifikuara. Për më tepër rezulton se të njëjtat prova janë paraqitur edhe nga vetë të paditurit bashkëlidhur deklaratës së mbrojtjes”.*

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse, pasi nga ana e saj në proces janë administruar provat të njësuara me origjinalin, konform nenit 251 të Kodit të Procedurës Civile dhe jo fotokopje të tyre, sikundër pretendon denoncuesja. Në lidhje me faktin nëse kemi të bëjmë me akte të falsifikuara, kjo nuk është në objektin e vlerësimit të aftësive

¹⁰⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 12.7.2023 të ILD-së (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 13.7.2023).

¹¹⁰ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit, të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

profesionale, pasi një gjë e tillë duhet të analizohet nga Gjykata e Apelit, sikundër është shprehur edhe prokuroria¹¹¹ kur ka vendosur pushimin e çështjes.

66.4 Denoncim nr. * prot., datë 5.7.2021, i av. M.B**

Denoncuesi ka sqaruar se ka qenë mbrojtës/përfaqësues i viktimave të veprës penale D.B dhe F.B kundër të pandehurit S.M, që lidhet me procedimin penal nr. ***, viti 2019, për kryerjen e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal. Sipas sqarimeve, çështja është gjykuar nga gjyqtarja Mirela Mishgjoni, e cila ka pranuar kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar. Ai pretendon se pasi prokurori dhe mbrojtja e të pandehurit kanë parashtruar konkluzionet përfundimtare, ai si përfaqësues i viktimave ka kërkuar të parashtrrojë konkluzionet përfundimtare të përgatitura me shkrim, por nuk është lejuar nga gjykata.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim¹¹² dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm informoi se çështja nuk është planifikuar ende për gjykim.

Subjektit iu kërkuar shpjegime në lidhje me këtë denoncim.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi¹¹³: *“Gjykata gjatë gjithë zhvillimit të këtij gjykimi ka respektuar me përpikëri parashikimet procedurale penale... viktimat nuk kanë marrë dijeni për seancën gjyqësore të datës 21.4.2021, për rrjedhojë gjykata ka caktuar një seancë tjetër... në seancën e datës 1.7.2021, seancë e zhvilluar në prani të palëve dhe viktimave, i pandehuri ka parashtruar konkluzionet përfundimtare. Av. M.B nuk ka kërkuar fjalën, për rrjedhojë gjykata e ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor. Në datën 21.7.2021 është shpallur vendimi dhe në këtë seancë është paraqitur vetëm viktimat”.*

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej saj, Komisionit i rezultoi se nga dokumentacioni i gjendur në dosjen gjyqësore është përfshirë edhe dokumenti “Pretendime përfundimtare të viktimës”, i datës 7.6.2021, firmosur nga viktimat dhe av. M.B. Nga verifikimi i procesverbaleve të seancës rezulton se në të gjitha seancat ka qenë prezent viktimat dhe në disa prej tyre edhe av. M.B. Në përfundim të gjykimit, subjekti ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit.

Për sa më sipër, rezulton se shpjegimet e subjektit janë bindëse.

66.5 Denoncim nr. * prot., datë 7.11.2023, i shtetasit S.S**

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit cakton eksperte psikologe znj. B.L në 99% të çështjeve gjyqësore me objekt “Zgjidhje martesë”, duke krijuar dyshime për njëanshmëri, por edhe për korrupsion. Sipas denoncuesit, caktimi i ekspertës në të gjitha çështjet gjyqësore nuk përputhet as me Udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2014, të Këshillit të Ministrave, sipas të cilit çdo eksperti nuk mund t’i caktohet më shumë se 30% e çështjeve gjyqësore në një vit kalendarik.

¹¹¹ Shihni pikën 8.4.1 të rezultateve të hetimit.

¹¹² Informacion i dërguar në Komision nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nr. *** prot., datë 21.9.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 28.9.2023).

¹¹³ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit, të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

Për sa më sipër, duket se subjekti mund të ketë vepruar në kundërshtim me udhëzimin nr. 4, si dhe ka pranuar akti e ekspertimit nga një eksperte, e cila ka ofruar edhe këshillim për një nga palët në gjykim.

Në çështjen gjyqësore të denoncuesit, ekspertja ka paraqitur faturë në vlerën 48,000 lekë, si dhe dy fatura në shumën 60,000 lekë, me përshkrimin “Seanca këshillimi për paditësin R.S”.

Subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të paraqesë prova në lidhje me përfundimin e këtij gjykimi, si dhe me frekuencën e caktimit të ekspertes B.L në çështjet e saj gjyqësore.

Subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit shpjegoi se¹¹⁴: *“Nga verifikimi i kryer nga sekretaria gjyqësore i të gjitha gjykimeve me objekt zgjidhje martese që kam zhvilluar gjatë viteve 2023 dhe 2024, rezulton se gjatë kësaj periudhe në gjykimet me objekt “Zgjidhje martese” kam caktuar në mënyrë të barabartë ekspert psikolog të licencuar dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qytetin e Vlorës. Gjatë këtij gjykimi kam zbatuar me përpikëri legjislacionin procedural civil, duke garantuar të drejtat e palëve pjesëmarrëse në gjykim”.*

Pasi analizoi provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni konstaton se bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 26.3.2024, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se subjekti ka gjykuar për periudhën 2022 –2023 24 çështje gjyqësore, me objekt “Zgjidhje martese”, ku ka caktuar psikolog. Në këto çështje subjekti ka caktuar 3 psikologë, 2 prej të cilëve u janë caktuar në mënyrë të barabartë me nga 11 çështje secili, ndërsa njërit vetëm 2 çështje. Ndërkohë, subjekti nuk e ka depozituar dosjen gjyqësore të gjykimit, duke mbetur në nivel deklarativ pretendimet e saj në lidhje me gjykimin e çështjes.

Pasi ka marrë informacion nga organet ligjzbatuese, Komisioni i ka dërguar shkresë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë për të administruar dosjen gjyqësore me palë z. A.M, ku ngriheshin dyshime se subjekti ka zhvilluar seancat gjyqësore pa prezencën e palëve. Në datën 23.10.2023, me shkresën nr. *** prot., të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, është administruar dosja gjyqësore që u përket palëve A.M (M) dhe E.M, e cila është gjykuar nga një tjetër subjekt rivlerësimi, si dhe çështja me palë shtetasit A.O (M) dhe M.O, e cila është gjykuar nga subjekti.

Komisioni nga analizimi i fashikullit gjyqësor ka konstatuar se nga ana e subjektit është pranuar të marrë pjesë në seancën e datës 1.10.2018 shtetasi D.M, i cili nuk ka qenë i pajisur me prokurë për të përfaqësuar palët në gjykim. Nga Komisioni nuk u konstatua si e rregullt marrja dijani për zhvillimin e seancave gjyqësore nga shtetasi A.O, pavarësisht faktit se ka nënshkruar babai i tij, i cili nuk rezulton të ketë qenë i pajisur me prokurë. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këto konstatime.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi se¹¹⁵: *“Në seancën e pajtimit të datës 1.10.2018, gjykata ka kryer verifikimin e palëve ndërgjyqëse. Nga verifikimi ka rezultuar se paditësja kishte komunikuar me sekretarinë, duke njoftuar se ishte në pamundësi të paraqitej në orarin e caktuar dhe ka kërkuar disa minuta kohë. Gjykata ka ndërprerë seancën 15 minuta dhe,*

¹¹⁴ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit, të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

¹¹⁵ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit, të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

pas rifillimit, në seancë është paraqitur shtetasi D.M, i cili ka deklaruar se është babai i të paditurit dhe ka justifikuar mosparaqitjen e palës paditëse. Pra, rezulton se paraqitja e shtetasit D.M nuk ka qenë në cilësinë e përfaqësuesit të palëve, por në kuadër të justifikimit të mosparaqitjes së palës paditëse. Bazuar në këtë fakt, gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës së pajtimit, duke urdhëruar njoftimin përsëri të palëve ndërgjyqëse. Në lidhje me pranimin si të rregullt të marrjes dijeni për zhvillimin e seancave, bazuar në nenet 130, 131 dhe 132 të Kodit të Procedurës Civile, nëpunësi gjyqësor, pasi e ka pasur të pamundur të njoftojë personalisht të paditurin, ka vijuar me dorëzimin e njoftimit një anëtar i familjes sipas parashikimeve të nenit 131 të Kodit të Procedurës Civile, konkretisht babait të të paditurit”.

Pasi analizoi provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni konstaton se shpjegimet e saj janë bindëse. Ajo ka sqaruar se prezenca e z. M në seancë nuk ka qenë në cilësinë e përfaqësuesit të palëve, si dhe i është referuar nenit 131 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, në qoftë se personi i thirrur nuk gjendet, njoftimi i dorëzohet një personi të familjes që ka mbushur moshën 16 vjeç.

66.6 Denoncim i shtetasit A.M¹¹⁶

Denoncuesi pretendon se subjekti ka nxjerrë akte që ulin besimin e qytetarëve tek sistemi i drejtësisë. Nga ana e tij janë cituar dy vendime të subjektit, si vijon:

- *Vendim nr. ***, datë 23.12.2016* – Në lidhje me këtë vendim, denoncuesi pretendon se subjekti nuk ka zbatuar dispozitat e nenit 512 e vijues të Kodit Penal, pasi ka vendosur konvertimin e dënimit nga 20 vjet në 10 vjet.
- *Vendim nr. ***, datë 29.5.2023* – Në lidhje me këtë vendim, denoncuesi pretendon se subjekti ka dhënë një vendim të pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit procedural dhe penal.

Në lidhje me këtë denoncim janë administruar të dyja vendimet e mësipërme me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2024. Nga analizimi i këtyre vendimeve konstatohet se:

Subjekti në datën 23.12.2016 me vendimin nr. *** ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Njohjen e vendimit gjyqësor penal të huaj kundër shtetasit M.D, konvertimin e dënimit në 10 vite burgim. Në lidhje me këtë vendim ka paraqitur ankim Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke kërkuar dënimin e shtetasit M.D me 20 vjet burgim për veprën penale “Vrasje me paramendim”. Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 23.2.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të subjektit. Në këtë vendim, Gjykata e Apelit shprehet se në referim dhe zbatim të shkronjave “c” dhe “d” të nenit 11 të Konventës, në funksion të shkurtimit të periudhës prej 20 vitesh, burgim të caktuar nga gjykata italiane, Gjykata e Apelit vlerëson se duhet të aplikojë nenin 76 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, duke caktuar një dënim sipas parashikimeve të nenit 76 të Kodit Penal me 10 vjet burgim. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 15.9.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit, pasi

¹¹⁶ Nr. ***, datë 18.1.2024.

ai ishte marrë në zbatim të gabuar të legjislacionit procedural penal dhe të vendimit unifikues nr. 5/2002. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me vendimmarrjen e saj.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi se¹¹⁷: *“Vendimi i Gjykatës së Lartë për zbatim të gabuar të legjislacionit procedural penal i referohet gjykimit të kryer në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjatë këtij gjykimi kam zbatuar me përpikëri konventat ndërkombëtare, legjislacionin procedural penal dhe vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjatë gjykimit ka rezultuar se plotësoheshin të gjitha kushtet e njohjes së vendimit penal të huaj...*

Duke iu referuar neneve 3 dhe 10 të Konventës së Këshillit të Evropës dhe nenit 514 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se në vendimin e njohjes gjykata, pasi verifikon nëse vendimi ka marrë formë të prerë, pasi verifikon nëse të dënuarit i janë respektuar të drejtat procedurale penale në përputhje me legjislacionin dhe, pasi verifikon nëse gjykimi i të dënuarit është kryer nga një gjykatë e pavarur dhe e pandikuar nga konsiderata lidhur me racën, fenë, duhet t'i japë faktit penal për të cilin është dënuar ky shtetas cilësimin juridik, pra dispozitën përkatëse të parashikuar në legjislacionin penal shqiptar... nga analiza e faktit penal, për të cilin ishte deklaruar fajtor dhe dënuar shtetasi M.D, ka rezultuar se vepra penale e vrasjes së parashikuar nga neni 575 i Kodit Penal italian, në rrethanat e kryera i korrespondon veprës penale të vrasjes me dashje, të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal shqiptar. Neni 110 i Kodit Penal parashikon kryerjen e veprës penale në bashkëpunim, ndërsa neni 575 i Kodit Penal italian parashikon: “Cilido që shkakton vdekjen e një personi, dënohet me burgim jo më pak se 21 vjet”.

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse në lidhje me respektimin e procedurës së parashikuar nga legjislacioni procedural penal shqiptar. Për sa i përket vendimmarrjes së subjektit, pavarësisht se nga ana e saj mund të mos jetë zbatuar dispozita përkatëse e Kodit Penal, kjo i përket themelit të çështjes dhe bindjes së brendshme të subjektit, që mund të merret në shqyrtim vetëm nga gjykata më të larta.

Subjekti në datën 29.5.2023 me vendimin nr. **** ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit V.A... dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale urdhërohet zbritja e 1/3 së masës së dënimit.

Komisioni ka konstatuar se subjekti ka vendosur dënimin e këtij shtetasi në minimumin e parashikuar nga Kodi Penal, ndërkohë që nuk plotësohej asnjë nga rrethanat lehtësuese të parashikuara nga neni 48 i këtij Kodi, për rrjedhojë duket se subjekti nuk ka argumentuar vendimin.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi se¹¹⁸: *“Oficerët e policisë gjyqësore që kanë shoqëruar shtetasin K.A, në aparatën e tij celular kanë konstatuar dy foto të vëllait të tij me armë në dorë. Është shoqëruar shtetasi V.A, i cili ka deklaruar se armën e ka gjetur në një kosh plehrash, e ka lyer dhe e ka fshehur në një pikë skrapë në pronësi të shtetasit E.S... nga kontrolli i kryer në këtë ambient është gjetur arma... në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, gjykata ka pasur parasysh rrethanat konkrete të kryerjes së veprës penale, vendin ku është gjetur arma e*

¹¹⁷ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit, të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

¹¹⁸ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit, të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

zjarrit, faktin që nga mbajtja e këtij sendi nuk kanë ardhur pasoja. Pavarësisht se në favor të të pandehurit nuk ka pasur asnjë nga rrethanat e parashikuara nga neni 48, gjykata ka mbajtur në konsideratë nenin 49 të Kodit Penal, si dhe marzhin e dënimit të parashikuar nga 5 - 7 vjet”.

Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse dhe duhet të merren në konsideratë. Në nenin 49 të Kodit Penal parashikohet se: *“Gjykata, pavarësisht nga rrethanat që përmenden në nenin 48 të këtij Kodi, mund të marrë në konsideratë edhe rrethana të tjera, për sa kohë i quan të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit”.*

Në këto kushte, subjekti ka konsideruar si rrethana lehtësuese vendin ku është gjetur arma, rrethanat konkrete të kryerjes së veprës penale, moshën e të pandehurit, faktin që nuk ka pasur precedent penal, zhvillimin e tij arsimor dhe kulturor.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se nga ana e subjektit vlerësimi i rrethanave lehtësuese, për sa kohë nuk provohet se ato janë bërë për të favorizuar të pandehurin, është në diskrecion të saj dhe, për rrjedhojë, nuk konstatohet mangësi profesionale.

67. Komisioni ka konstatuar disa artikuj si më poshtë në lidhje me subjektin e rivlerësimit:

- [https://www.v.p.tv/***/para/ https://www.t.al/**/](https://www.v.p.tv/***/para/https://www.t.al/***/)
- https://tv.al/-***
- https://www.news.tv***

67.1 Sa u përket artikujve, subjekti ka shpjeguar¹¹⁹: *“Në lidhje me artikullin e ***, rezulton se vendimi është dhënë në datën 25.11.2015, ndërkohë ngjarja kriminale që i referohet artikulli ka ndodhur në vitin 2019. Në caktimin e dënimit të shtetasit K.C gjykata i është referuar faktit që arma është gjetur në banesë, rrethanave familjare të të pandehurit, qëndrimin pendues, faktit që ka qenë bashkëpunues, si dhe nuk kishte precedentë penalë. Në dosjen gjyqësore të të pandehurit nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me aktivitetin kriminal të pretenduar në këtë artikull. Kryerja më pas prej këtij shtetasi e veprimeve të kundërligjshme nuk mund të parashikohet nga gjykata, e cila shqyrton vetëm faktin penal të ndodhur dhe, kur analizon rrezikshmërinë e të pandehurit, u referohet rrethanave të mëparshme dhe aktuale ku mund të jetë përfshirë, por e ka të pamundur t’u referohet situatave që mund të ndodhin në të ardhmen.*

*Në lidhje me artikullin e TV *** me shortin elektronik të datës 1.9.2021, më është caktuar për gjykim çështja penale ndaj të pandehurve M.V dhe I.V, akuzuar në bazë të nenit 237/3 të Kodit Penal. Në të kundërt nga sa pretendohet në atë artikull, gjykata e ka shqyrtuar këtë çështje brenda afateve procedurale të parashikuara nga neni 332 i Kodit të Procedurës Penale, duke shpallur vendimin në datën 7.10.2021.*

*Në lidhje me artikullin e *** News, me vendimin nr. ***, datë 28.8.2021, kam vendosur ndaj shtetasit F.LL masën e sigurimit personal “Arrest në burg”. Me vendimin nr. ***, datë 13.4.2022, kam vendosur zëvendësimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” për shkak të gjendjes shëndetësore së të dyshuarit. Prokuroria ka qenë dakord me këtë masë, duke parashtruar se përveç*

¹¹⁹ Për më shumë referojuni provave dhe shpjegimeve të subjektit, të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit.

ekzistencës së arsyeve shëndetësore, masa duhet ndryshuar edhe për faktin se qenia e kërkuesit në masën e sigurimit personal “Arrest në burg” nuk është më e nevojshme në gjendjen në të cilën ndodhen hetimet, duke pasur parasysh faktin se të gjitha provat janë marrë dhe pritet vetëm përgjigjja e ekspertëve, pra i dyshuari nuk mund të dëmtojë marrjen e provave. Në përfundim të hetimeve, i dyshuari F.LL është dërguar për gjykim vetëm për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Në artikull nuk përmendet fakti se është pikërisht kjo gjyqtare që ka dënuar me burgim të përjetshëm shtetasin A.LL”.

67.2 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni në lidhje me këta artikuj konstaton se nga ana e saj nuk konstatohen veprime që mund të konsiderohen si mangësi profesionale.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

68. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

69. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruar nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Mirela Mishgjoni, gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
 4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, në datën 05.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese (kundër)

Alma FASKAJ
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka